



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 110

Tiranë – E hënë, 12 korrik 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 419, datë 8.7.2021	Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në digën e Qyrsaqit, HEC Vau i Dejës, qarku Shkodër, nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.).....	10137
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 421, datë 8.7.2021	Për miratimin e rregullores së përgjithshme të Shërbimit të Provës.....	10139
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 5, datë 25.6.2021	Për miratimin e rregullave mbi shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare.....	10162
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4840/4, datë 8.7.2021	Për shpronësim dhe/ose për shkëmbimin e pronës, për interes publik, në zonën e re për zhvillim në Njësinë Administrative Marikaj, Bashkia Vorë.....	10166



VENDIM
Nr. 419, datë 8.7.2021

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË
CENTRALIT GJENERUES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE
FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE
NDIHMËSE, I CILI NUK PËRFITON
NGA MASAT MBËSHTETËSE, NË
DIGËN E QYRSAQIT, HEC VAU I
DEJËS, QARKU SHKODËR, NGA
KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE
SHQIPTARE (KESH SHA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në digën e Qyrfaqit, HEC Vau i Dejës, Qarku Shkodër, nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH, sh.a.), me elementet, si më poshtë vijon:

- a) emri i aplikuesit: Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.);
- b) NIPT/NUIS i aplikuesit: J61817005F;
- c) tipi centralit: Fotovoltaik;
- ç) kapaciteti i instaluar: 5.143 mwp;
- d) afati i pritshëm i vënies në punë: Koha për ndërtimin dhe vënien në operim të parkut fotovoltaik do të jetë brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga marrja e lejes së ndërtimit;
- dh) vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Në digën e Qyrfaqit, HEC Vau i Dejës, qarku Shkodër;
- e) afati i miratimit të ndërtimit: 48 (dyzet e tetë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij miratimi;
- ë) koordinatat e tokës sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucione të tjera të autorizuar prej saj, kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore, gjatë realizimit dhe vënies në punë, me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

g) Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.) ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht, çdo 3 (tre) muaj, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ose institucioneve të tjera të autorizuar prej saj, informacion mbi ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. detyrimin e dorëzimit të sigurimit të kontratës, në masën jo më pak se 5 (pesë) % të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.) dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj.

iv. të japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë, sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.), duhet t’i derdhë tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



ANEKSI 1
PLAN-VENDOSJA E SIPËRFAQES SË OBJEKTIT



Pika	Koordinatat Gauss-Kruger
1	4387134.839; 4654365.533
2	4387492.655; 4654428.567
3	4387239.040; 4654175.274
4	4387436.758; 4654318.596



VENDIM
Nr. 421, datë 8.7.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
SË PËRGJITHSHME
TË SHËRBIMIT TË PROVËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pika 7, 20, pika 2, 25, pika 6, 26, pika 6, 27, pika 5, 29, pika 4, dhe 32, pika 3, të ligjit nr. 78/2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore së përgjithshme të Shërbimit të Provës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr. 302, datë 25.3.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullore ‘Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative’”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës për zbatimin e ndjekjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

RREGULLORE E PËRGJITHSHME E
SHËRBIMIT TË PROVËS

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objkti

Objkti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të hollësishme, lidhur me:

a) organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës;

b) procedurën e mbikëqyrjes së të dënuarve ndaj të cilëve janë vendosur alternativa të dënimit me burgim;

c) mbikëqyrjen e masave të shmangies nga ndjekja penale dhe dënimet jo me burgim për të miturit;

ç) rregullat për ndryshimin e vendbanimit apo të vendqëndrimit të personit nën mbikëqyrje;

d) ofrimin e mbështetjes për personat nën mbikëqyrje;

dh) trajtimin e rasteve të mospërmbushjeve të detyrimeve nga personi nën mbikëqyrje;

e) kryerjen e inspektimeve, të drejtat e detyrat e inspektorëve dhe të subjekteve të inspektuara.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është parashikimi i rregullave të detajuara, në kuadër të mirëfunksionimit të Shërbimit të Provës dhe degëve të saj territoriale, për rehabilitimin dhe riintegrimin e personave ndaj të cilëve janë vendosur alternativa të dënimit me burgim apo masat e shmangies dhe dënimet jo me burgim për të miturit në konflikt me ligjin.

KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
SHËRBIMIT TË PROVËS

Neni 3
Rregulla të përgjithshme që drejtojnë
veprimtarinë e Shërbimit të Provës

1. Shërbimi i Provës kryen veprimtarinë e saj, duke respektuar Kushtetutën, legjislacionin në fuqi dhe të gjitha aktet nënligjore të nxjerra në zbatim dhe në funksion të kësaj veprimtarie.

2. Shërbimi i Provës është organ i centralizuar dhe realizon aktivitetin dhe veprimtarinë në nivel qendror, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, si dhe në nivel vendor, nëpërmjet degëve territoriale të Shërbimit të Provës.

3. Drejtimi dhe organizimi i veprimtarisë së Shërbimit të Provës kryhet nga drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës.

4. Shërbimi i Provës bashkëpunon dhe paraqet informacion e raporte para prokurorisë dhe gjykatës, sipas parashikimeve ligjore.

5. Shërbimi i Provës përcakton metodat e zbatimit të alternativave të dënimit me burgim në



përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

6. Shërbimi i Provës, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë, bashkëpunon me institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e arsimit të lartë, subjekte private, organizata të shoqërisë civile dhe organizata ndërkombëtare.

7. Shërbimi i Provës garanton mbështetje të veçantë për të mbikëqyrurit që kanë aftësi të kufizuara gjatë gjithë procedurës së ekzekutimit të vendimit.

8. Nëpunësit dhe punonjësit administrativ të Shërbimit të Provës ushtrojnë detyrat funksionale sipas përshkrimit të punës dhe bazuar në detyrat e ngarkuara nga eprori.

9. Në veprimtarinë e përditshme nëpunësi dhe punonjësi administrativ i Shërbimit të Provës mban parasysh parimin e unitetit, hierarkisë, paanësisë, pavarësisë politike, përgjegjshmërisë, profesionalizmit, qartësisë në caktimin e detyrave, bashkëpunimit, konfidencialitetit, si dhe rregullat e etikës.

10. Nëpunësit dhe punonjësit administrativ të Shërbimit të Provës, gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësisve publike, shmangin rastet që, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, ndikojnë, mund të ndikojnë apo duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të tyre, duke u ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

Neni 4

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës

1. Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës në marrëdhënie me të tretët, organizon e kontrollon veprimtarinë e saj dhe është përgjegjës për mirëfunksionimin e institucionit të Shërbimit të Provës.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Drejtësisë.

3. Kandidatët për drejtor të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës duhet të plotësojnë kriteret e

përcaktuara sipas ligjit për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës. Niveli minimal i diplomës është “Master shkencor” apo “Master profesional” të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike apo të barasvlershme me to sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë.

Neni 5

Përgjegjësitë e drejtorit të Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm, në përputhje me detyrat e veta, është përgjegjës për:

a) drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e veprimtarisë së Shërbimit të Provës;

b) marrjen e masave që Shërbimi i Provës të veprojë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të detyrave ligjore;

c) përgatitjen dhe nxjerrjen e urdhrave, udhëzimeve të brendshme dhe metodikave për trajtimin e çështjeve në kompetencë të Shërbimit të Provës;

ç) urdhërimin e kryerjes së inspektimeve të veprimtarisë së degëve territoriale të Shërbimit të Provës;

d) hartimin dhe zhvillimin e strategjive të trajnimit të specialistëve të Shërbimit të Provës për përmirësimin e rolit të tyre dhe të nivelit të përgjegjësisve profesionale;

dh) përfaqësimin e Shërbimit të Provës në marrëdhënie me të tretët;

e) raportimin periodik pranë ministrit të Drejtësisë për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për Shërbimin e Provës;

ë) kryerjen e çdo detyre tjetër të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Degët territoriale të Shërbimit të Provës

1. Degët territoriale të Shërbimit të Provës kryejnë veprimtarinë e tyre në nivel vendor. Degët territoriale drejtohen nga drejtori i degës territoriale.

2. Drejtori i degës territoriale të Shërbimit të Provës përgjigjet për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e përmbushjes së detyrave nga



specialistët me qëllim realizimin e misionit të Shërbimit të Provës.

3. Drejtori i degës territoriale:

a) garanton zbatimin e vendimeve alternative dhe mbështetjen e personave nën mbikëqyrje në procesin e riintegritimit të tyre në shoqëri nga specialistët e degës territoriale të Shërbimit të Provës;

b) identifikon dhe krijon regjistrin e riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të degës territoriale e ia paraqet drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës;

c) informon drejtpërdrejt drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit të Provës për veprimtarinë e degës territoriale të Shërbimit të Provës;

ç) jep informacione specifike dhe statistikore bazuar në legjislacionin në fuqi sipas kërkesave për numrin e subjekteve në mbikëqyrje;

d) mban kontakte të vazhdueshme me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës për mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore të degës territoriale të Shërbimit të Provës;

dh) në cilësinë e eprorit direkt, identifikon nevojat dhe mundëson trajnimin e rritjen profesionale të nëpunësve civilë në varësi, me qëllim rritjen e nivelit të tyre profesional dhe përditësimin e njohurive të tyre në fushën e veprimtarisë së Shërbimit të Provës;

e) merr pjesë dhe përgatit vlerësimin periodik të nëpunësve civilë të degës territoriale të Shërbimit të Provës.

4. Niveli minimal i diplomës për kandidatët për drejtor të degës territoriale të Shërbimit të Provës është “Master shkencor” apo “Master profesional” të përfutuar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë.

Neni 7

Stema dhe vula e Shërbimit të Provës

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës ka stemën dhe vulën e saj zyrtare. Stema e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë,

Ministria e Drejtësisë, Shërbimi i Provës”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

2. Degët territoriale të Shërbimit të Provës kanë stemën dhe vulën e tyre zyrtare. Stema e degëve territoriale përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Shërbimi i Provës, Dega Territoriale ... (emri i degës territoriale)”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

3. Vula e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe vulat e degëve territoriale kanë formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vulat prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU III

RREGULLAT PËR PROCEDURËN DHE STANDARDET E MBIKËQYRJES NGA SHËRBIMI I PROVËS

Neni 8

Vendosja e kontaktit të parë të personit nën mbikëqyrje me Shërbimin e Provës

1. Drejtori i degës territoriale të Shërbimit të Provës, pas administrimit të urdhrimit të ekzekutimit të nxjerrë nga prokurori, sipas legjislacionit për ekzekutimin e vendimeve penale, verifikon kompetencën territoriale dhe cakton, brenda 2 (dy) ditëve nga administrimi i urdhrimit të ekzekutimit, specialistin përgjegjës për mbikëqyrjen e alternativave të dënimit me burgim apo mbikëqyrjen e të miturve në konflikt me ligjin.

2. Specialisti i Shërbimit të Provës, përgjegjës për mbikëqyrjen, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e caktimit të tij, verifikon përmbushjen vullnetare të detyrimit të personit nën mbikëqyrje për të vendosur kontakt me Shërbimin e Provës.

3. Në rastin kur personi nën mbikëqyrje nuk ka përmbushur detyrimin për të vendosur kontaktin me Shërbimin e Provës, specialisti i ngarkuar i njofton atij detyrimin për të vendosur



kontakt. Në njoftim përcaktohen vendi dhe adresa e Shërbimit të Provës, data dhe ora e kontaktit, kontakti telefonik dhe elektronik i specialistit të Shërbimit të Provës, përgjegjës për mbikëqyrjen, si dhe pasojat që rrjedhin nga mospërbushja e detyrimit. Personi nën mbikëqyrje vendos kontakt me specialistin përgjegjës të Shërbimit të Provës brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

4. Në rast se personi në mbikëqyrje nuk paraqitet brenda afatit të caktuar, i dërgohet një njoftim i dytë të nesërmen e përfundimit të afatit nëpërmjet punonjësit të policisë, kompetent për territorin, dhe shërbimit të policisë gjyqësore. Në rast se edhe pas njoftimit të dytë personi nuk gjendet, specialisti i Shërbimit të Provës i paraqet prokurorit raport mospërbushjeje.

5. Specialisti i Shërbimit të Provës, përgjegjës për mbikëqyrjen e personit nën mbikëqyrje të mitur, i realizon njoftimet sipas këtij neni nëpërmjet kujdestarit ose përfaqësuesit të tij ligjor të përcaktuar në vendimin gjyqësor.

6. Në kontaktin e parë me personin nën mbikëqyrje, specialisti i Shërbimit të Provës verifikon identitetin e tij dhe e informon në gjuhë të kuptueshme prej tij për qëllimin dhe objektivat e mbikëqyrjes, për të drejtat dhe garancitë ligjore, për detyrimet e tij sipas vendimit gjyqësor, si dhe për pasojat që rrjedhin nga mospërbushja e tyre.

7. Specialisti i Shërbimit të Provës informon personin nën mbikëqyrje edhe për detyrimin e tij për të respektuar rregullat e mirësjelljes, veçanërisht me ato që kanë të bëjnë me shmangien e sjelljeve të dhunshme apo agresive dhe shmangien e përdorimit të gjuhës së papërshtatshme që cenojnë specialistët e Shërbimit të Provës.

8. Për personat që kanë aftësi të kufizuara Shërbimi i Provës garanton komunikim të përshtatshëm e të kuptueshëm prej tyre. Personit me dëmtim në të parë, veprimet informuese i komunikohen me gojë dhe ai përgjigjet me gojë. Personit me dëmtim në dëgjim, veprimet informuese i paraqiten me shkrim dhe ai përgjigjet me gojë. Personit me dëmtim në të folur veprimet informuese i komunikohen me gojë dhe ai përgjigjet me shkrim. Personit me dëmtime në dëgjim dhe në të folur i paraqiten pyetjet dhe paralajmërimi me shkrim dhe ai

përgjigjet me shkrim. Në qoftë se personi me ndonjërin nga aftësitë e kufizuara nuk di të lexojë ose të shkruajë, specialisti i Shërbimit të Provës cakton një ose më shumë interpretë të zgjedhur ndërmjet atyre personave që kanë njohur të komunikojnë me ta.

9. Specialisti i Shërbimit të Provës veprimet informuese i regjistron në procesverbal, i cili nënshkruhet prej tij dhe personit nën mbikëqyrje. Kur personi nën mbikëqyrje është i mitur, procesverbali nënshkruhet edhe nga prindi apo kujdestari i tij ligjor dhe mbrojtësi. Për personat që kanë aftësi të kufizuara, procesverbali mbahet në një mënyrë të përshtatshme që personi ta kuptojë dhe ta lexojë atë.

10. Kur, për shkak të aftësive të kufizuara, personi e ka të pamundur të realizojë vetë të drejtën e mbrojtjes, veprimet informuese i komunikohen këtij të fundit në praninë e një mbrojtësi.

11. Në kontaktin e parë me personin nën mbikëqyrje, specialisti i Shërbimit të Provës kryen një vlerësim paraprak për situatën e personit nën mbikëqyrje, me qëllim hartimin e planit individual të trajtimit.

12. Specialisti i Shërbimit të Provës kryen vlerësimin e personalitetit të personit nën mbikëqyrje, me qëllim analizimin e nevojave për mungesat fizike, afektive ose shoqërore. Në hartimin e planit individual të trajtimit, specialisti i Shërbimit të Provës bazohet dhe në:

- a) veprimet a mosveprimet penale, rrezikshmërinë shoqërore dhe dëmin e shkaktuar;
- b) situatën familjare, ekonomike e sociale dhe qëndrimin e personit nën mbikëqyrje ndaj saj;
- c) planet afatshkurtra e afatgjata të personit nën mbikëqyrje dhe mënyrat për realizimin e tyre.

13. Nëse nga vlerësimi rezulton se personi nën mbikëqyrje është përdorues i pijeve alkoolike apo i substancave narkotike e psikotrope, specialisti i Shërbimit të Provës vlerëson llojin e substancave të përdorura dhe mënyrat e sigurimit të substancës, periudhën dhe historikun e konsumimit të substancës, si dhe, nëse është rasti, institucionin ku personi nën mbikëqyrje është regjistruar për trajtim.

14. Në përfundim të kontaktit të parë me personin nën mbikëqyrje, specialisti i Shërbimit



të Provës e njofton atë për datën dhe vendin e takimit të ardhshëm.

15. Specialisti i Shërbimit të Provës, pas kontaktit të parë, regjistron personin në regjistrin e personave nën mbikëqyrje.

Neni 9

Dosja personale

1. Për çdo person nën mbikëqyrje krijohet dosje personale, plotësimi i së cilës fillon gjatë procesit penal dhe vazhdon deri në përfundimin e ekzekutimit të dënimit.

2. Dosja personale përmban:

a) raportin e vlerësimit të përgatitur gjatë fazës së hetimeve paraprake për caktimin e dënimit alternativ, nëse ka; vendimin gjyqësor penal që cakton dënimin alternativ;

b) një fotokopje të dokumentit të identifikimit të personit nën mbikëqyrje;

c) vendimin gjyqësor penal që cakton dënimin alternativ;

ç) urdhrin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të lëshuar nga prokurori;

d) raportin mjekësor për vlerësimin e kushteve shëndetësore, kur është e nevojshme;

dh) procesverbalin e kontakteve me personin nën mbikëqyrje;

e) planin individual të trajtimit;

ë) raportet e përpiluara nga Shërbimi i Provës dhe të dërguara në gjykatë ose prokurori gjatë periudhës së mbikëqyrjes;

f) çdo paralajmërim të dhënë nga prokurori për shkelje të detyrimeve të vendosura nga gjykata gjatë periudhës së mbikëqyrjes;

g) një ekstrakt të paralajmërimit të bërë nga prokurori në rastin e shkeljeve të lehta dhe të kryera për herë të parë, nëse ka;

gj) raportin përfundimtar të hartuar nga Shërbimi i Provës në përfundim të mbikëqyrjes;

h) të dhëna për përparimin e personit nën mbikëqyrje gjatë periudhës së mbikëqyrjes;

i) kopje të ankesave të personit nën mbikëqyrje për Shërbimin e Provës dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre;

j) kopje të ankesës së personit nën mbikëqyrje, për të dhënat dhe përmbajtjen e dosjes personale;

k) urdhrin e caktimit të institucionit të ekzekutimit të masës alternative;

l) instrumentin e vlerësimit të rrezikshmërisë;

ll) çdo dokument tjetër lidhur me personin nën mbikëqyrje, që është i nevojshëm për realizimin e mbikëqyrjes.

3. Informacioni i përfshirë në dosjen personale duhet të jetë i besueshëm, objektiv dhe të jetë i lidhur vetëm me çështjet që i referohen masës apo llojit të dënimit dhe ekzekutimit të tij.

4. Specialisti i Shërbimit të Provës, i caktuar për mbikëqyrjen e personit, informon personin nën mbikëqyrje për të drejtën për t'u njohur me aktet në dosjen personale, si dhe i shpjegon atij përmbajtjen e dosjes.

5. Dosja personale e shërbimit të provës dhe përmbajtja e saj, pas përfundimit të periudhës së provës, trajtohet në përputhje me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat.

Neni 10

Regjistrat e Shërbimit të Provës

1. Çdo degë territoriale e Shërbimit të Provës, në përmbushje të detyrave funksionale, mban në formë shkresore regjistrat, sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës krijon regjistrin elektronik, në të cilin regjistron të dhënat e degëve territoriale. Të dhënat e këtij regjistri përditësohen çdo javë.

Neni 11

Shfrytëzimi i të dhënave

1. Të dhënat lidhur me personin nën mbikëqyrje ruhen dhe përpunohen në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të drejtën për t'u konsultuar me përmbajtjen e dosjes personale të Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes e kanë personi nën mbikëqyrje ose prindi ose kujdestari i tij ligjor, mbrojtësi, gjyqtari ose prokurori.

2. Dhënia e informacioneve të dosjes personale apo regjistrat lejohet vetëm në rast se këto informacione kanë lidhje me ushtrimin e detyrave të autoritetit që e kërkon atë, në përputhje me funksionet dhe rolin e tyre në zbatimin e vendimit. Në çdo rast, ndalohet dhënia e informacioneve për veprën penale dhe personalitetin e personit nën mbikëqyrje pa pëlqimin e shprehur të tij.



Neni 12

Plani individual i trajtimit

Shërbimi i Provës vlerëson personalitetin e të mbikëqyrurit dhe harton planin individual të trajtimit, sipas formatit të miratuar nga ministri i Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për Shërbimin e Provës.

Neni 13

Mbështetja e personit nën mbikëqyrje

1. Shërbimi i Provës, në kuadër të riintegritimit në shoqëri të personit nën mbikëqyrje, shmangien e rrezikut për përsëritjen e veprave penale ose për normalizimin e marrëdhënieve me viktimën ose familjarët, në bazë të vlerësimit të personalitetit dhe nevojave të personit nën mbikëqyrje, e ndihmon atë për të kapërcyer vështirësitë që has gjatë ekzekutimit të vendimit penal.

2. Shërbimi i Provës kontakton me familjen e personit nën mbikëqyrje, persona të tjerë të afërt me të, kryen vëzhgim të mjedisit social të personit nën mbikëqyrje, bashkëpunon me organizata jofitimprurëse dhe shërbimin e ndërmjetësimit, me qëllim reduktimin dhe eliminimin e rrezikshmërisë shoqërore të personit nën mbikëqyrje dhe rehabilitimin e tij.

3. Me qëllim mbështetjen e personit nën mbikëqyrje për punësim, strehim, kujdes shëndetësor, formim profesional dhe, në rastin e të miturve, edhe arsimim, Shërbimi i Provës bashkëpunon, vihet në kontakt, lidh marrëveshje bashkëpunimi ose memorandume mirëkuptimi me organe publike, persona juridikë privatë ose organizata jofitimprurëse vendase apo të huaja, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

4. Shërbimi i Provës merr informacion në mënyrë periodike mbi ecurinë dhe riintegrimin e personit nën mbikëqyrje.

Neni 14

Detyrat e specialistit të Shërbimit të Provës në lidhje me mbështetjen e të mbikëqyrurit

1. Kur gjykata në vendimin e saj ka caktuar një ose më shumë nga detyrimet e parashikuara në Kodin Penal, Shërbimi i Provës inkurajon dhe

mbështet të mbikëqyrurin në përmbushjen e detyrimeve dhe verifikon përmbushjen e tyre.

2. Specialisti i Shërbimit të Provës, i cili është caktuar për mbështetjen e të mbikëqyrurit, identifikon institucionet në nivel vendor që mund të mbështesin përmbushjen e një apo më shumë detyrimeve të vendosura nga gjykata dhe të parashikuara në marrëveshjet e bashkëpunimit ose memorandumet e mirëkuptimit, siç janë: Policia e Shtetit, institucionet arsimore, qendrat e arsimit dhe formimit profesional apo të trajnimit, qendrat e punës, institucionet shëndetësore publike apo organizatat jofitimprurëse që ofrojnë programe rehabilitimi.

Neni 15

Raporti i Shërbimit të Provës

1. Në përmbushje të detyrave funksionale, specialisti i Shërbimit të Provës harton raportin e vlerësimit, duke analizuar rrethanat sociale që lidhen me personin nën hetim, të pandehurin, personin nën mbikëqyrje dhe të miturin në konflikt me ligjin.

2. Në rastin e fazës së hetimeve paraprake dhe të gjykimit, ky raport hartohet nga një specialist i caktuar nga drejtori i degës territoriale. Në rastet e fazës së ekzekutimit të dënimit penal, raporti hartohet nga specialisti i caktuar me mbikëqyrjen e personit në mbikëqyrje.

3. Raporti i vlerësimit paraqet të dhëna, që i vijnë në ndihmë prokurorit ose gjykatës në marrjen e vendimit në çdo fazë të procedimit penal, bazuar në informacione të detajuara dhe në analizën e rrethanave, shkaqeve të kryerjes së veprës penale dhe qëndrimeve të tij të paraqitura nga Shërbimi i Provës në mënyrë të qartë dhe të arsyetuar.

4. Shërbimi i Provës paraqet në raport mendimin për llojin dhe kohëzgjatjen e dënimit të përshtatshëm. Ky mendim jepet në mënyrë objektive dhe të paanshme, pavarësisht qëndrimeve të prokurorisë apo të mbrojtësit.

5. Raporti i vlerësimit paraqitet në formë të përmbledhur, duke shmangur termat e specializuar apo shprehjet që vështirësojnë kuptimin e tij.

6. Gjatë kryerjes së vlerësimit, specialisti i Shërbimit të Provës takohet lirisht me personin



nën hetim, të pandehurin ose personin nën mbikëqyrje.

7. Çdo institucion shtetëror, ent publik ose subjekt privat bashkëpunon me Shërbimin e Provës dhe vendos në dispozicion të tij informacionin e nevojshëm për përgatitjen e raportit të vlerësimit në përputhje me rregullat dhe afatet e parashikuara nga legjislacioni i posaçëm në fuqi.

8. Në rastet kur nevojitet një analizë komplekse dhe e specializuar psikologjike, sociologjike, pedagogjike, mjekësore apo analizë tjetër e ngjashme, dega territoriale i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme ekspertizën e duhur për të hartuar raportin e vlerësimit.

9. Specialisti i Shërbimit të Provës kontakton anëtarë të familjes, persona nga institucionet arsimore apo vendi i punës dhe çdo person tjetër që mund të ofrojë informacion të dobishëm për hartimin e raportit të vlerësimit.

10. Nëse personi për të cilin është kërkuar raporti i vlerësimit nuk bashkëpunon, specialisti i Shërbimit të Provës shënon faktin e refuzimit të bashkëpunimit në raport.

11. Nëse personi për të cilin është kërkuar raporti nuk gjendet, Shërbimi i Provës njofton prokurorin ose gjykatën që ka kërkuar raportin, duke përgatitur një njoftim të posaçëm që tregon faktet e gjetura dhe pamundësinë e hartimit të raportit të vlerësimit.

Neni 16

Detyrat e specialistit të Shërbimit të Provës në lidhje me hartimin e raportit

1. Specialisti i Shërbimit të Provës i caktuar për të hartuar raportin e vlerësimit:

a) cakton menjëherë, por jo më vonë se 3 (tri) ditë nga marrja e kërkesës për hartimin e raportit të vlerësimit nga gjykata ose prokurori, vendin, datën dhe orën e kontaktit të parë me personin për të cilin është kërkuar raporti i vlerësimit. Kontakti i parë duhet të zhvillohet brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e kërkesës për hartimin e raportit të vlerësimit nga gjykata apo prokurori. Në rastin e të miturve, specialisti i Shërbimit të Provës përcakton vendin, datën dhe orën e takimit apo të takimeve me të miturin, në praninë e detyrueshme të prindit ose të kujdestarit ligjor dhe mbrojtësit apo, kur është e nevojshme, në

praninë e personave apo të përfaqësuesve të institucioneve, të cilëve u është besuar mbikëqyrja e të miturit;

b) kontakton çdo person dhe institucion që mund të ofrojë informacion të dobishëm rreth personit që duhet vlerësuar rreth arsimit, punësimit, strehimit, sjelljes, shëndetit, rrethanave të tij shoqërore e familjare;

c) regjistron, në çdo takim, të dhënat e nevojshme dhe të dobishme për hartimin e raportit të vlerësimit;

ç) i propozon drejtorit të degës territoriale, kur çmohet e nevojshme, të marrë masat e parashikuara në pikën 7, të nenit 15, të kësaj rregulloreje;

d) harton raportin e vlerësimit bazuar në informacionin e marrë dhe ia paraqet për shqyrtim dhe miratim drejtorit të degës territoriale të Shërbimit të Provës;

dh) i dërgon raportin e vlerësimit organit procedues brenda afatit të kërkuar prej tij.

Neni 17

Mospërbushja e kushteve dhe e detyrimeve që rrjedhin nga alternativa e dënimit me burgim

1. Kur specialisti i Shërbimit të Provës konstaton se personi nën mbikëqyrje ka shkelur kushtet dhe detyrimet që i janë vendosur nga gjykata, ka detyrimin të verifikojë rrethanat dhe shkaqet penguese dhe të njoftojë prokurorin.

2. Kur institucionet shtetërore apo subjektet private konstatojnë mospërbushje të detyrimeve nga personi nën mbikëqyrje, brenda 5 (pesë) ditëve, i raportojnë Shërbimit të Provës, i cili njofton prokurorin.

3. Në rastin kur specialisti i Shërbimit të Provës konstaton apo njoftohet nga subjekte të tjera për mospërbushjen e detyrimeve nga personi nën mbikëqyrje, menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë, vihet në kontakt me personin nën mbikëqyrje dhe i kërkon shpjegime për arsyet dhe rrethanat që kanë shkaktuar mospërbushjen e detyrimeve. Specialisti i Shërbimit të Provës, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga vendosja e kontaktit me personin nën mbikëqyrje, harton raport të detajuar lidhur me arsyet e mospërbushjes së detyrimit. Ky raport i përcillet prokurorit



menjëherë, por, në çdo rast, jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga vendosja e kontaktit me personin nën mbikëqyrje.

4. Në rast pamundësie të përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve që rrjedhin nga dënimi alternativ, pasi verifikon faktet dhe rrethanat që ndikojnë në pamundësinë e përmbushjes, Shërbimi i Provës i dërgon menjëherë një raport vlerësimi prokurorit për arsyet e mospërmbushjes së detyrimeve nga i mbikëqyruri.

5. Shërbimi i Provës i bashkëlidh raportit të dhëna lidhur me mospërmbushjen nga ana e të mbikëqyrurit të detyrimeve të vendosura nga gjykata.

6. Raporti përmban edhe rekomandimin e Shërbimit të Provës për prokurorin, për veprimet që duhen ndërmarrë, në përputhje me shkallën e rrezikshmërisë së shkeljes, dhe vlerësimin që ky institucion i ka bërë rastit.

7. Llojet e rekomandimeve për prokurorin janë:

- a) dhënia e një paralajmërimi në rastet e të miturve ose shkeljeve të kryera për herë të parë;
- b) paraqitja e kërkesës drejtuar gjykatës për të ndryshuar detyrimin;
- c) paraqitja e kërkesës drejtuar gjykatës për të shtuar detyrime të tjera;
- ç) paraqitja e kërkesës drejtuar gjykatës për t'i zëvendësuar ato me dënime të tjera; ose
- d) paraqitja e kërkesës drejtuar gjykatës për të revokuar vendimin dhe vijimin e dënimit me burgim.

Neni 18

Ndryshimi i vendbanimit, vendqëndrimit, qendrës së punës apo lëvizjet e shpeshta

1. Personi nën mbikëqyrje ka detyrimin për të njoftuar paraprakisht me shkrim specialistin e caktuar me mbikëqyrjen e tij për ndryshimin e vendbanimit apo vendqëndrimit të zakonshëm, me përjashtim të rasteve urgjente kur njoftimi bëhet fillimisht nëpërmjet telefonit dhe më pas me shkrim. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga ndryshimi i vendbanimit apo vendqëndrimit të zakonshëm, i mbikëqyruri i paraqet specialistit të caktuar për mbikëqyrjen të dhënat e detajuara rreth situatës së re.

2. Në rastin e udhëtimeve që i tejkalojnë 8 (tetë) ditë, i mbikëqyruri në provë informon

Shërbimin e Provës për adresën e vendit ku do të qëndrojë, numrin e telefonit dhe ditën e kthimit nga udhëtimi.

3. Nëse vendbanimi apo vendqëndrimi i ri i personit ndodhet në një zonë jashtë kompetencës tokësore të degës territoriale të Shërbimit të Provës të ngarkuar fillimisht me çështjen, kjo e fundit, brenda 3 (tre) ditëve, i dërgon degës territoriale të Shërbimit të Provës, në kompetencën tokësore të së cilës gjendet vendbanimi apo vendqëndrimi i ri i personit nën mbikëqyrje, dosjen personale të personit nën mbikëqyrje të vënë në provë dhe njofton menjëherë gjykatën që ka dhënë vendimin.

4. Në rastin e ndryshimit të qendrës së punës, i mbikëqyruri në provë njofton me shkrim Shërbimin e Provës dhe e informon atë për arsyet e ndryshimit, qendrën e re të punës, natyrën dhe veprimtaritë e punës. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga ndryshimi i qendrës së punës, i mbikëqyruri në provë i dërgon Shërbimit të Provës dokumentet që vërtetojnë dhe justifikojnë ndryshimin.

KREU IV MBIKËQYRJA E PERSONIT NË GJYSMËLIRI

Neni 19

Përcaktimi i institucionit

1. Në rastet kur gjykata vendos ekzekutimin e vendimit me burgim në gjysmëliri, Shërbimi i Provës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me urdhër të përbashkët, përcaktojnë institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, ku do të vendoset personi nën mbikëqyrje në gjysmëliri. Në përcaktimin e institucionit mbahen parasysh shkakut për të cilin gjykata ka caktuar dënimin alternativ të gjysmëlorisë dhe vendin ku personi duhet të përmbushë detyrimet personale jashtë burgut.

2. Modeli i urdhrimit miratohet nga ministri i Drejtësisë me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.



Neni 20

Plani individual i trajtimit

1. Në zbatim të vendimit të gjykatës për ekzekutimin e vendimit me burgim në gjysmëliri, Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një plan ditor individual për ekzekutimin e dënimit me gjysmëliri.

2. Ky plan përmban detyrimet e personit nën mbikëqyrje gjatë kohës që ndodhet jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, duke përcaktuar:

a) oraret e hyrjes dhe daljes në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale;

b) personat me të cilët personi nën mbikëqyrje lejohet ose ndalohet të mbajë kontakte gjatë kohës së qëndrimit jashtë institucionit;

c) ambientet e lejuara dhe ato të ndaluara për frekuentim;

ç) kushte të tjera, të cilat lidhen me përmbushjen e detyrimeve.

3. Shërbimi i Provës i raporton prokurorit dhe, kur është e nevojshme, drejtorit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, kur personi i dënuar me gjysmëliri nuk përmbush detyrimet e tij lidhur me punën, arsimimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare apo nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor, për qëllimin e dënimit.

4. Kur personi i dënuar me gjysmëliri nuk kthehet në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, drejtuesi i institucionit, pasi të ketë verifikuar faktet dhe rrethanat për moskthimin e tij, njofton prokurorin dhe Shërbimin e Provës. Shërbimi i Provës, pasi verifikon faktet dhe rrethanat, përgatit raport vlerësimi për prokurorin dhe gjykatën.

KREU V

MBIKËQYRJA E TË DËNUARVE PËR TË CILËT GJYKATA KA VENDOSUR PEZULLIMIN E EKZEKUTIMIT TË DËNIMIT ME BURGIM DHE VËNIEN NË PROVË

Neni 21

Ekzekutimi i vendimit për të dënuarin e vënë në provë

1. Në zbatim të vendimit të gjykatës për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë, Shërbimi i Provës vihet në kontakt me personin nën mbikëqyrje sipas rregullave të parashikuara në nenin 8, të kësaj rregulloreje.

2. I mbikëqyruri informohet për detyrimin e tij për të mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës gjatë zbatimit të dënimit.

3. Specialisti i Shërbimit të Provës harton dhe zhvillon një plan individual trajtimi për ekzekutimin e vendimit të gjykatës për pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien në provë, ku përcakton të drejtat dhe detyrimet e personit nën mbikëqyrje gjatë ekzekutimit të dënimit.

4. Specialisti i Shërbimit të Provës përcakton në planin individual të trajtimit kohëzgjatjen, frekuencën dhe vendin e takimeve me të mbikëqyrurin në provë.

Neni 22

Mosmbajtja e kontakteve me Shërbimin e Provës

1. Kur i mbikëqyruri në provë, për arsye objektive, nuk mund të jetë i pranishëm në njërin prej takimeve, njofton paraprakisht specialistin e Shërbimit të Provës.

2. Në rast se njoftimi nuk është i mundur, i mbikëqyruri paraqitet pranë Shërbimit të Provës brenda 3 (tri) ditëve nga shuarja e shkakut që ka sjellë pamundësinë dhe justifikon me dokumente arsyet objektive të mungesës së tij, të cilat përfshihen në dosjen personale.

3. Specialisti i Shërbimit të Provës mban procesverbal për mosrealizimin e kontaktit me të mbikëqyrurin të nesërmen e datës së takimit, duke pasqyruar të dhëna për mosrealizimin e kontaktit.



4. Specialisti i Shërbimit të Provës verifikon arsyet e parashtruara nga i mbikëqyruri dhe, kur çmon që arsyet nuk justifikojnë mungesën, e paralajmëron atë me shkrim. Të mbikëqyrurit i bëhen me dije pasojat e mospërbushjes së detyrimeve dhe i njoftohet data e takimit të ardhshëm, sipas planit individual të trajtimit.

5. Kur pas paralajmërimit i mbikëqyruri nuk paraqitet brenda afatit të caktuar, të nesërmen e përfundimit të afatit i dërgohet njoftim nëpërmjet punonjësit të policisë dhe shërbimit të Policisë Gjyqësore.

6. Nëse i mbikëqyruri nuk paraqitet brenda afatit të përcaktuar, në njoftimin e bërë nga punonjësit e policisë dhe shërbimit të Policisë Gjyqësore, specialisti i Shërbimit të Provës njofton drejtorin e degës territoriale, i cili, brenda 48 (dyzet e tetë) orëve, njofton prokurorin.

Neni 23

Mbikëqyrja e detyrimit për të ushtruar një veprimtari profesionale ose për të ndjekur arsimin ose arsimin dhe formim profesional

1. Kur gjykata ka caktuar për të mbikëqyrurin detyrimin për të ushtruar një veprimtari profesionale ose për të ndjekur arsimin ose arsimin dhe formimin profesional, Shërbimi i Provës merr masat për vendosjen e të mbikëqyrurit në formën e përshtatshme të veprimtarisë profesionale apo arsimimit dhe formimit profesional.

2. Specialisti i Shërbimit të Provës identifikon strukturat përgjegjëse që ofrojnë arsim apo arsimin dhe formim profesional në nivel vendor.

3. Nëse vendimi i gjykatës nuk specifikon llojin e veprimtarisë që do të ndiqet nga i mbikëqyruri në provë, Shërbimi i Provës përcakton llojin e aktivitetit dhe mënyrën e realizimit të tij.

4. Specialisti i Shërbimit të Provës kontrollon periodikisht nëse i mbikëqyruri në provë ndjek arsimimin apo arsimin dhe formimin profesional dhe mban procesverbal.

Neni 24

Mbikëqyrja e përmbushjes së detyrimeve financiare

1. Kur gjykata ka caktuar për të mbikëqyrurin detyrimin e përmbushjes së detyrimeve financiare apo riparimit e dëmit civil të shkaktuar, Shërbimi i Provës, gjatë kontaktit të parë, kërkon informacion

mbi vendbanimin ose vendqëndrimin, situatën dhe detyrimet financiare, qendrën e punës dhe kohëzgjatjen e kontratës së punësimit dhe, kur është rasti, informacion mbi personat në ngarkim të të mbikëqyrurit.

2. Shërbimi i Provës i shpjegon të mbikëqyrurit që ai duhet të përmbushë detyrimet e vendosura nga gjykata dhe diskuton me të mënyrën dhe kohën e përshtatshme të përmbushjes së detyrimeve financiare.

3. Shërbimi i Provës kontrollon periodikisht nëse i mbikëqyruri i përmbush detyrimet e vendosura nga gjykata dhe mban procesverbal.

Neni 25

Mbikëqyrja e përmbushjes së detyrimeve të tjera

1. Kur gjykata ka caktuar për personin nën mbikëqyrje një nga detyrimet e tjera të parashikuara në Kodin Penal, Shërbimi i Provës bashkëpunon ngushtësisht me njësitë e vetëqeverisjes vendore apo personat juridikë publikë apo privatë që mund të asistojnë në mbikëqyrjen e ekzekutimit të detyrimeve.

2. Brenda 3 (tre) ditëve nga kontakti i parë, Shërbimi i Provës i dërgon informacion për të mbikëqyrurin në provë Policisë së Shtetit ose çdo organizate tjetër apo institucioni që mund të asistojë mbikëqyrjen, duke kërkuar që, në rast mospërbushjeje të detyrimit, të njoftohet menjëherë.

3. Kur është e nevojshme, Shërbimi i Provës bën vizita pa lajmërim paraprak në vendbanimin ose vendqëndrimin e të mbikëqyrurit për të siguruar mbikëqyrjen efektive të detyrimeve. Nëpërmjet këtyre vizitave, Shërbimi i Provës mbledh faktet dhe bashkëpunon me familjen e të mbikëqyrurit, me qëllim asistimin e personit në përmbushjen e detyrimeve të vendosura.

4. Kur i mbikëqyruri në provë nuk përmbush kushtet dhe detyrimet e përcaktuara nga gjykata, Shërbimi i Provës paraqet një raport para prokurorit, i cili përmban informacion për rrethanat e shkeljes, shpjegimet e dhëna nga personi nën mbikëqyrje, vlerësimin e specialistit të Shërbimit të Provës dhe rekomandimin, së bashku me arsyet përkatëse, për të caktuar detyrime shtesë, për të kërkuar në gjykatë zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes apo për të ndryshuar kushtet e detyrimit për ekzekutimin e dënimit.



Neni 26

Mbikëqyrja e përmbyshjes së detyrimit për trajtim, mjekim apo rehabilitim

1. Kur gjykata ka caktuar për të mbikëqyrurin detyrimin e mjekimit ose rehabilitimit në një institucion shëndetësor ose të nënshtrimit ndaj një programi trajtimi, shëndetësor ose rehabilitues, Shërbimi i Provës identifikon, fillimisht, në nivel vendor, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga kontakti i parë, institucionin e përshtatshëm për përmbyshjen e këtij detyrimi. Ky institucion mund të jetë shëndetësor, organizatë jofitimprurëse, institucion apo shërbim, që realizojnë programe rehabilitimi për substancat narkotike apo psikotrope, alkoolin apo lloje të tjera programesh rehabilitimi.

2. Specialisti i Shërbimit të Provës, gjatë takimeve me të mbikëqyrurin në provë dhe kontakteve me personat përgjegjës për trajtimin, shëndetësor apo rehabilitimin, kontrollon nëse i mbikëqyruri në provë ndjek programet e trajtimit.

3. Me qëllim lehtësimin e përmbyshjes së detyrimeve, Shërbimi i Provës lidh marrëveshje me ministrinë përgjegjëse që mbulon fushën e kujdesit shëndetësor, si dhe organizatat jofitimprurëse dhe vendos ura bashkëpunimi me institucionet shëndetësore publike në varësi të kësaj ministrie dhe me ekspertë të organizatave jofitimprurëse për rregullimin e procedurave konkrete të bashkëpunimit.

4. Detyrimi konsiderohet i papërmbyshur kur i mbikëqyruri në provë:

- a) në mënyrë të paarsyeshme refuzon përfshirjen në një program trajtimi shëndetësor apo rehabilitues;
- b) në mënyrë të pajustificuar ndërpret programin e trajtimit shëndetësor apo rehabilitues.

Neni 27

Mbikëqyrja e të miturit të vënë në provë

1. Ekzekutimi i vendimit të gjykatës për vënien e të miturit në provë mbikëqyret nga Shërbimi i Provës.

2. Menjëherë, sapo urdhri i ekzekutimit të vënies në provë i përcillet Shërbimit të Provës, specialisti përgjegjës pranë degës territoriale të

Shërbimit të Provës, ku i mituri ka vendbanimin apo vendqëndrimin e zakonshëm, vendos kontaktin e parë me të miturin, i cili duhet të zhvillohet, në çdo rast, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga marrja e urdhrit të ekzekutimit.

3. Takimi zhvillohet në prani të mbrojtësit, prindit ose kujdestarit ligjor të të miturit dhe psikologut. Gjatë takimit, specialisti përgjegjës i Shërbimit të Provës e informon të miturin për të drejtat dhe detyrimet që gëzon gjatë procesit të mbikëqyrjes.

4. Mbështetur edhe në përmbyshjen e raportit të vlerësimit individual të të miturit, të hartuar nga Shërbimi i Provës gjatë fazës së hetimit apo gjykimit, pas takimit, specialisti i Shërbimit të Provës harton planin individual të trajtimit në bashkëpunim me të miturin, prindin ose kujdestarin e tij ligjor, mbrojtësin dhe Njësinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

5. Në përfundim të ekzekutimit specialisti i Shërbimit të Provës njofton me shkrim prokurorin për këtë fakt.

6. Në rast të shkeljes së detyrimeve nga i mituri i vënë në provë, Shërbimi i Provës harton një procesverbal paralajmërimi, i cili i njoftohet të miturit, prindit apo kujdestarit të tij ligjor, mbrojtësit dhe Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

7. Nëse i mituri i shmanget ekzekutimit të vendimit Shërbimi i Provës, pasi të ketë verifikuar faktet dhe rrethanat, i raporton prokurorit dhe, sipas rastit, i propozon ndryshimin e vendimit.

KREU VI

MBIKËQYRJA E TË DËNUARVE, PËR TË CILËT GJYKATA KA VENDOSUR QËNDRIMIN NË SHTËPI

Neni 28

Ekzekutimi i dënimit të dënimit alternativ me qëndrimin në shtëpi

1. Në zbatim të vendimit të gjykatës për qëndrimin në shtëpi, Shërbimi i Provës vihet në kontakt me personin nën mbikëqyrje, sipas rregullave të parashikuara në nenin 8, të kësaj rregulloreje.

2. Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program individual trajtimi për qëndrimin në shtëpi, ku përcakton, ndër të tjera, kushtet dhe



detyrimet e personit nën mbikëqyrje gjatë ekzekutimit të vendimit.

Neni 29

Mbikëqyrja dhe informimi për ekzekutimin e dënimit me qëndrim në shtëpi

1. Shërbimi i Provës kontakton njësitë e vetëqeverisjes vendore, strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në njësitë e vetëqeverisjes vendore, Policinë e Shtetit, si dhe çdo person juridik privat apo publik që mund të asistojë në ekzekutimin e alternativës së dënimit me qëndrim në shtëpi.

2. Kur gjykata lejon personin nën mbikëqyrje të largohet nga vendbanimi, Shërbimi i Provës harton planin individual të trajtimit në përputhje me masat e përcaktuara nga gjykata për kohën e kaluar jashtë shtëpisë. Shërbimi i Provës mbikëqyr mënyrën e respektimit nga personi nën mbikëqyrje të plotësisht të nevojave të domosdoshme familjare të lejuara nga gjykata.

3. Shërbimi i Provës, në rastet kur gjykata pranon kërkesën për ndryshimin e vendbanimit, zbaton masat e përcaktuara në këtë vendim dhe i përcjell praktikën e ekzekutimit për personin nën mbikëqyrje degës territoriale të Shërbimit të Provës, ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin e ri.

4. Shërbimi i Provës njofton lidhur me ndryshimin e vendbanimit ose të vendqëndrimit strukturat vendore të Policisë së Shtetit, si dhe prokurorin që ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit.

5. Shërbimi i Provës siguron informacionin dhe mbështetjen e nevojshme për personin nën mbikëqyrje nga institucionet shëndetësore, strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe organizatat jofitimprurëse që bashkëpunojnë me të për zbatimin e vendimit me qëndrim në shtëpi.

Neni 30

Mospërbushja e kushteve dhe detyrimeve

1. Në rastin kur personi nën mbikëqyrje nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga alternativa e dënimit me qëndrim në shtëpi, Shërbimi i Provës verifikon faktet dhe rrethanat që kanë sjellë mospërbushjen dhe i raporton prokurorit të çështjes.

2. Kur Shërbimi i Provës çmon që personi nën mbikëqyrje nuk ka përmbushur detyrimet si rezultat i pamundësisë objektive, ai i propozon prokurorit ndryshimin e detyrimeve, në përputhje me mundësitë dhe nevojat e personit nën mbikëqyrje, sipas rregullave të përcaktuara në këtë rregullore.

KREU VII

MBIKËQYRJA E TË DËNUARVE, PËR TË CILËT GJYKATA KA VENDOSUR PEZULLIMIN E EKZEKUTIMIT TË DËNIMIT ME BURGIM DHE DETYRIMIN PËR KRYERJEN E NJË PUNE ME INTERES PUBLIK

Neni 31

Përcaktimi i llojit dhe vendit të punës

1. Kur gjykata ka caktuar ndaj personit nën mbikëqyrje alternativën e dënimit me burgim të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe detyrimin e kryerjes së një pune në interes publik, Shërbimi i Provës harton planin individual të trajtimit.

2. Kur gjykata në vendimin e saj ka caktuar kryerjen e një pune në favor të interesit të një organizate jofitimprurëse, Shërbimi i Provës përcakton llojin e punës dhe ditët e javës.

3. Në caktimin e llojit, përshkrimin, ditëve apo të orëve të punës Shërbimi i Provës vlerëson llojin e veprës penale të kryer, si dhe arsimin, moshën, gjendjen shëndetësore, aftësitë profesionale, përvojën e mëparshme dhe kushte të tjera sociale apo familjare të personit nën mbikëqyrje.

4. Shërbimi i Provës, në caktimin e vendit, ku do të kryhet puna me interes publik, merr në konsideratë vendbanimin ose vendqëndrimin e personit nën mbikëqyrje.

5. Kur brenda territorit të vendbanimit të personit nën mbikëqyrje nuk ka një institucion të përshtatshëm, Shërbimi i Provës cakton një institucion tjetër të së njëjtës natyre, i cili ndodhet në njësinë administrative më të afërt me vendbanimin e personit nën mbikëqyrje.



Neni 32

Plani individual i trajtimit

1. Pas përcaktimit të institucionit, Shërbimi i Provës harton planin individual të trajtimit për kryerjen e punës me interes publik, i cili përmban:

a) ditët e javës gjatë të cilave do të kryhet puna, oraret për fillimin dhe mbarimin e punës dhe veprimtaritë e përditshme;

b) mënyrën e takimeve me specialistin e Shërbimit të Provës;

c) elemente të tjera të nevojshme, që lidhen me llojin dhe përshkrimin e punës, vendin, mënyrën e kryerjes së punës etj.

2. Kur personi nën mbikëqyrje është i mitur, programi ditore hartohet duke marrë parasysh moshën, interesin më të lartë të të miturit, nevojat individuale, gjininë dhe personalitetin e tij. Në hartimin e programit ditore Specialisti i Shërbimit të Provës konsultohet me prindërit, kujdestarin, mbrojtësin e tij ose persona të tjerë të kërkuar nga i mituri.

3. Shërbimi i Provës lidh marrëveshje me subjektet, ku do të kryhet puna me interes publik për përmbushjen e planit individual të trajtimit. Marrëveshja përcakton planin, punën që do të kryhet, personin përgjegjës të caktuar nga subjektet për të mbikëqyrur realizimin e punës nga personi nën mbikëqyrje, si dhe detyrimin e subjekteve për të njoftuar menjëherë Shërbimin e Provës në rastet e mospërmbushjes nga personi nën mbikëqyrje të detyrimeve.

4. Personi përgjegjës i caktuar për mbikëqyrjen evidenton orët e punës mbi baza ditore, për të verifikuar nëse orari i punës ditore është respektuar apo jo, si dhe informon rregullisht Shërbimin e Provës për nivelin e performancës në punë të personit nën mbikëqyrje.

Neni 33

Informimi i personit nën mbikëqyrje për ekzekutimin e dënimit

1. Para fillimit të punës, Shërbimi i Provës informon personin nën mbikëqyrje për detyrimin e tij për të përmbushur udhëzimet e dhëna dhe detyrat që rrjedhin nga puna që ai kryen.

2. Shërbimi i Provës informon personin nën mbikëqyrje për detyrimin e tij për të mbajtur kontakte me të.

Neni 34

Të drejtat dhe detyrat e personit nën mbikëqyrje

Gjatë kryerjes së punës, personi nën mbikëqyrje gëzon të drejta të njëjta me punëmarrësit e tjerë, lidhur me mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë në punë, mirëqenien sociale dhe kohëzgjatjen e punës e të pushimit, si dhe çdo të drejtë të parashikuar nga legjislacioni në fuqi që rregullon marrëdhëniet e punës, me përjashtim të kufizimeve që rrjedhin nga natyra e dënimit dhe përmbushja e detyrimeve të tij.

Neni 35

Mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimit

1. Shërbimi i Provës mbikëqyr personin nën mbikëqyrje gjatë ekzekutimit të vendimit për kryerjen e punës në interes publik.

2. Subjekti, pranë të cilit kryhet puna në interes publik, kur konstaton mospërmbushje të detyrimeve përkatëse nga personi nën mbikëqyrje, brenda 5 (pesë) ditëve i raporton Shërbimit të Provës, i cili njofton prokurorin.

Neni 36

Mospërmbushja e kushteve dhe detyrimeve

Specialisti i Shërbimit të Provës, kur konstaton se personi nën mbikëqyrje nuk kryen punën me interes publik apo shkel kushtet dhe detyrimet që i janë vendosur nga gjykata, ka detyrimin të verifikojë rrethanat dhe shkaqet penguese dhe të njoftojë prokurorin.

Neni 37

Përfundimi i punës me interes publik

Subjekti, pranë të cilit është kryer puna me interes publik, në përfundim të punës, njofton Shërbimin e Provës me një raport për të gjitha detyrimet e përmbushura gjatë periudhës së punës me interes publik. Raporti përmban dhe një vlerësim të përgjithshëm për kryerjen e



detyrave të ngarkuara, respektimin e orarit, marrëdhëniet në punë etj. Ky raport bëhet pjesë e dosjes individuale për t'u paraqitur në gjykatë nga specialisti i Shërbimit të Provës.

KREU VIII
**MBIKËQYRJA E TË DËNUARVE, PËR
 TË CILËT GJYKATA KA VENDOSUR
 LIRIMIN ME KUSHT**

Neni 38
Plani individual i trajtimit

Në zbatim të vendimit të gjykatës për pezullimin e dënimit me burgim dhe lirim me kusht të personit, Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program individual trajtimi për ekzekutimin e vendimit të lirimit me kusht.

Neni 39
**Mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimit të
 lirimit me kusht**

1. Shërbimi i Provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të lirimit me kusht dhe, kur është e nevojshme, bashkëpunon me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me Policinë e Shtetit. Ai informon personin nën mbikëqyrje për detyrimin e tij për të raportuar rregullisht pranë Shërbimit të Provës lidhur me kryerjen e dënimit.

2. Në rastet kur gjykata ka vendosur lirim me kusht ndaj një të dënuari të mitur, Shërbimi i Provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të gjykatës, lidhur me përmbushjen e detyrimeve nga i mituri, duke mbajtur në konsideratë interesin më të lartë të tij dhe mbështetjen gjatë periudhës në lirim me kusht, për të bërë të mundur një riintegrim të suksesshëm të tij.

Neni 40
Pamundësia e përmbushjes së detyrimeve

Në rastin kur personi nën mbikëqyrje nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet, që rrjedhin nga lirimi me kusht, Shërbimi i Provës, pasi verifikon kushtet dhe rrethanat për mospërmbushjen e tyre, njofton prokurorin e çështjes dhe bën propozime lidhur me ndryshimin e detyrimeve.

KREU IX
**ZBATIMI I VENDIMEVE PËR MASAT E
 SHMANGIES NGA NDJEKJA PENALE
 DHE DËNIMET JO ME BURGIM PËR TË
 MITURIT**

Neni 41
**Mbikëqyrja e të miturve në konflikt
 me ligjin**

1. Shërbimi i Provës është përgjegjës për ekzekutimin e masave të shmangies dhe dënimet jo me burgim për të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe legjislacionit në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale.

2. Gjatë këtij procesi, Shërbimi i Provës udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të të miturit dhe i ofron të miturit ndihmë edukative, arsimore, psikologjike, mjekësore dhe fizike, si dhe mbrojtje sociale në përshtatje me nevojat individuale dhe në përputhje me moshën, gjininë dhe personalitetin e tij, me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin në jetën shoqërore.

3. Kur kërkohet nga gjykata për aplikimin e masave të shmangies apo caktimin e llojit të dënimit, Shërbimi i Provës harton raportin e vlerësimit individual dhe planin individual të trajnimit për të miturin.

Neni 42
Raporti i vlerësimit individual

1. Shërbimi i Provës, me kërkesë të prokurorit ose të gjykatës, paraqet, jo më vonë se 14 (katërmëdhjetë) ditë nga marrja e kërkesës, raportin e vlerësimit për të miturin në konflikt me ligjin.

2. Nëse i mituri nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe, i sigurohet një përkthyes nga Shërbimi i Provës.

3. Specialisti i Shërbimit të Provës vendos kontaktin me të miturin dhe e informon atë, së bashku me prindin apo kujdestarin ligjor, avokatin dhe psikologun, për kohën dhe vendin e takimit, për zhvillimin e intervistës, për hartimin e raportit. Ky njoftim kryhet me mjete teknike të përshtatshme që garantojnë njoftimin, si: telefoni, telegrafi, telegrami, faksi apo posta elektronike.



4. Në mungesë të konfirmimit të njoftimit ose nëse nuk është e mundur gjetja e vendndodhjes së të miturit, specialisti duhet të kontaktojë prokurorin ose gjykatën, apo edhe Policinë e Shtetit, për të kërkuar më tepër informacion lidhur me vendndodhjen e të miturit.

5. Nëse i mituri ndaj të cilit kërkohet hartimi i raportit të vlerësimit individual nuk gjendet, specialisti informon prokurorin apo gjykatën për situatën, ku tregohen faktet dhe arsyet pse nuk është i mundur hartimi i raportit individual të vlerësimit.

6. Në rast pamundësie objektive për hartimin e raportit të vlerësimit brenda afateve të përcaktuara nga prokuroria ose gjykata ose kur, për hartimin e raportit, kërkohen të dhëna shtesë që bëjnë të nevojshëm shtyrjen e afateve, Shërbimi i Provës njofton prokurorin ose gjykatën për pamundësinë e hartimit të raportit të vlerësimit në afatin e përcaktuar, duke parashtruar edhe arsyet përkatëse. Në çdo rast, Shërbimi i Provës harton raportin e vlerësimit jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga dita e njoftimit të arsyeve të shtyrjes.

7. Specialisti i Shërbimit të Provës mund të shfrytëzojë ambientet e zyrave të degëve territoriale, të Qendrave Sociale Multidisiplinare, organizatave jofitimprurëse, ambiente të tjera të bashkive apo çdo ambient tjetër me të cilat Ministria e Drejtësisë ose Shërbimi i Provës ka marrëveshje bashkëpunimi ose memorandume mirëkuptimi.

8. Në mënyrë që raporti individual i vlerësimit të jetë sa më i plotë, specialisti i Shërbimit të Provës merr mendim edhe nga Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve të juridiksionit, ku ka vendbanimin i mituri lidhur me gjendjen ekonomike, familjare, komunitare etj.

9. Raporti individual i vlerësimit përmban rekomandime konkrete, bazuar në personalitetin e të miturit, situatën ekonomike, familjare, sociale, komunitare, arsimimin etj.

10. Gjatë zhvillimit të intervistës, i mituri informohet për:

- a) qëllimin e intervistës;
- b) mënyrën e zhvillimit të intervistës;
- c) faktet dhe rrethanat që do të diskutohen gjatë intervistës;
- ç) kohëzgjatjen;

d) informacionet që do të mblidhen nga burime të tjera;

dh) faktin se çdo gjë që i mituri thotë gjatë intervistës mund të përdoret për qëllimet e vlerësimit dhe të paraqitet në raportin individual të vlerësimit dhe se raporti do të depozitohet te prokurori/gjykata dhe do të jetë pjesë e dokumentacionit të rastit;

e) ruajtjen e konfidencialitetit nga Shërbimi i Provës;

ë) pjesëmarrjen në hartimin e raportit përpara përfundimit;

f) të drejtën që gjatë intervistës të shprehë lirisht mendimin dhe të jetë pjesë aktive e gjetjes së zgjidhjes më të mirë.

11. Për hartimin e raportit specialisti i Shërbimit të Provës takohet lirisht me të miturin në prani të psikologut apo punonjësit social, prindit apo kujdestarit të tij ligjor dhe mbrojtësit. Numri i takimeve duhet të jetë i kufizuar, me qëllim shmangien e ekspozimit të të miturit ndaj stresit.

12. Specialisti i Shërbimit të Provës përdor instrumentin e vlerësimit të riskut si pjesë e raportit të vlerësimit individual.

13. Raporti i vlerësimit individual nënshkruhet nga specialisti i Shërbimit të Provës, prindi ose nga kujdestari i tij ligjor dhe mbrojtësi. Një kopje e raportit të vlerësimit individual u vihet në dispozicion personit nën mbikëqyrje, kujdestarit të tij ligjor dhe mbrojtësit.

Neni 43

Plani individual i trajtimit

1. Shërbimi i Provës harton planin individual të trajtimit për të miturin në konflikt me ligjin sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, legjisllacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim.

2. Plani individual i trajtimit përmban informacione për të miturin të mbledhura nga vlerësimi i riskut. Plani tregon dhe identifikon masat e nevojshme në secilën kategori të riskut për të rehabilituar dhe për të riintegruar të miturin në shoqëri.

3. Plani përmban aktivitete që kanë të bëjnë me nevojat e identifikuar si historiku i sjelljes



antisociale, modeli i personalitetit antisocial, qëndrimi ndaj veprës penale, personat me të cilët shoqërohet, arsimi dhe punësimi, marrëdhëniet familjare, koha e lirë dhe përdorimi i substancave alkoolike, narkotike, psikotrope apo substancave të tjera. Gjithashtu, plani përmban dhe aktivitete që adresojnë nevoja të tjera që mund të lidhen me shëndetin fizik dhe mendor, kushtet e jetesës dhe nevoja shtesë.

4. Planit individual i trajtimit nënshkruhet nga specialisti i Shërbimit të Provës, prindi ose kujdestari i tij ligjor dhe mbrojtësi. Një kopje e planit individual i dorëzohet personit nën mbikëqyrje, prindit ose kujdestarit të tij ligjor dhe mbrojtësit.

5. Shërbimi i Provës njofton të miturin, prindin ose kujdestarin ligjor të të miturit dhe mbrojtësin brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga miratimi i tij dhe i vendos në dispozicion një kopje të planit individual.

Neni 44

Mbikëqyrja e shmangies nga ndjekja penale për të miturit

1. Specialisti i Shërbimit të Provës, përgjegjës për mbikëqyrjen, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e administrimit të urdhrin të ekzekutimit, verifikon përmbushjen vullnetare të detyrimit të personit nën mbikëqyrje për të vendosur kontakt me Shërbimin e Provës. Në rastin kur personi nën mbikëqyrje, në përfundim të afatit 7-ditor nuk ka përmbushur vullnetarisht detyrimin për të vendosur kontaktin me Shërbimin e Provës, specialisti përgjegjës për mbikëqyrjen i njofton atij detyrimin për të vendosur kontakt.

2. Specialisti i Shërbimit të Provës, përgjegjës për mbikëqyrjen, vendos kontakt me të miturin, prindin ose kujdestarin e tij ligjor dhe mbrojtësin brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

3. Specialisti i Shërbimit të Provës, në kontaktin e parë me të miturin, verifikon identitetin e tij dhe e njofton atë, prindin ose kujdestarin e tij ligjor, për qëllimin dhe objektivat e mbikëqyrjes, për të drejtat dhe garancitë ligjore, për detyrimet e tij sipas vendimit gjyqësor, si dhe për pasojat që rrjedhin nga mospërmbushja e tyre.

4. Specialisti i Shërbimit të Provës vendos kontaktet me institucionet e tjera të përcaktuara për zbatimin e marrëveshjes së shmangies.

Neni 45

Mbikëqyrja e zbatimit të masave detyruese dhe detyrimet e caktuara

1. Për zbatimin e masave detyruese të vendosura nga gjykata në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, Shërbimi i Provës bashkëpunon me strukturat vendore të Policisë së Shtetit, ofruesit publikë dhe privatë të shërbimeve për të miturit, mësuesit, prindërit ose kujdestarët e të miturit.

2. Për arsimimin e të miturit, specialisti i Shërbimit të Provës bashkëpunon me drejtuesin dhe përfaqësuesin e institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, si dhe me mësuesit për të ndjekur ecurinë e të miturit, lidhur me frekuentimin e mësimin, ecurinë e rezultateve dhe vlerësimin e njohurive, angazhimin në mësim, marrëdhëniet me bashkëmoshatarët dhe mësuesit etj.

3. Specialisti i Shërbimit të Provës bashkëpunon edhe me strukturën për mbrojtjen e të miturit dhe strukturat arsimore në nivel vendor për përcaktimin e institucionit arsimor, ku do të regjistrohet i mituri, si dhe për ndjekjen e ecurisë së tij.

4. Në rast se ndaj të miturit është caktuar masa e ndjekjes së një programi të arsimit dhe formimit profesional, specialisti bashkëpunon me drejtuesit e programeve mësimore arsimore dhe të formimit profesional, si dhe me personelin mësimdhënës të institucionit.

5. Për zbatimin e masës detyruese për kryerjen e një pune nga i mituri, specialisti bashkëpunon me drejtuesin e zyrës rajonale ose vendore të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

6. Specialisti i Shërbimit të Provës bashkëpunon me shërbimet e shëndetit mendor për të miturit dhe të rinjtë në nivel vendor ose qendror, drejtoritë/institucionet e kujdesit shëndetësor, Njësinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, drejtoritë rajonale të shërbimit social shtetëror ose Urdhrin e Psikologut, me qëllim përmbushjen e masës detyruese për të miturin për të kryer një program edukativ, korrigjues dhe/ose mjekësor.



7. Procedura për përmbushjen e detyrimeve nga i mituri, në kuadër të rishoqërimit të tij dhe parandalimin e rikryerjes së veprës penale, përcaktohet në planin individual të trajtimit për të miturin.

8. Shërbimi i Provës, veç parashikimeve të përgjithshme, gjatë hartimit dhe zbatimit të planit individual për të miturin në konflikt me ligjin, në përmbushjen e këtij detyrimi, mban në vëmendje:

a) që të përfshijë shpjegime dhe këshillim të herëpashershëm të të miturit lidhur me sjelljet që ndikojnë negativisht në edukimin e tij;

b) përcaktimin e vendeve që nuk duhet të frekuentohen nga i mituri;

c) një listë të personave me të cilët i mituri nuk duhet të shoqërohet;

ç) bashkëpunimin e ngushtë me familjen, shkollën dhe shoqërinë civile, veçanërisht në mbikëqyrjen nga ana tyre të përdorimit të mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe informacionit të transmetuar në rrugë elektronike.

Neni 46

Programet e drejtësisë restauruese dhe/ose ndërmjetësimi

1. Shërbimi i Provës mbikëqyr të miturin ndaj të cilit janë caktuar programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimi, në bashkëpunim me shërbimin e ndërmjetësimi.

2. Specialisti i Shërbimit të Provës bashkëpunon me shërbimin e ndërmjetësimi për mbikëqyrjen e ecurisë së programit të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimi. Specialisti i Shërbimit të Provës mban kontakt me ndërmjetësin dhe merr një kopje të procesverbaleve të takimeve të ndërmjetësimi.

3. Ndërmjetësimi mund të zhvillohet vetëm me pjesëmarrjen personale të të miturit, autor i veprës penale, dhe palës së dëmtuar. Në procesin e ndërmjetësimi, me pëlqimin e palëve, mund marrin pjesë gjithashtu përfaqësuesi ligjor i të miturit, psikologu, punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, prokurori dhe/ose personat e tjerë të caktuar prej tij. Prokurori mund të marrë pjesë në procesin e ndërmjetësimi, nëse ai e vlerëson.

4. Në rast të përmbushjes së programit të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimi, brenda

45 (dyzet e pesë) ditëve, specialisti harton raportin përfundimtar të përmbushjes së masës së shmangies. Në rast se nuk përmbushet brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, specialisti harton raportin e mospërmbushjes së masës së shmangies.

Neni 47

Përmbushja e masave të shmangies

1. Kur i mituri përmbush detyrimet e vendosura, Shërbimi i Provës njofton prokurorin apo gjykatën nëpërmjet hartimit të raportit të përmbushjes së masës së shmangies.

2. Raporti i përmbushjes së masës së shmangies përmban:

a) gjenealogjet e të miturit nën mbikëqyrje;

b) të dhënat që lidhen me vendimin dhe me rrethanat e çështjes;

c) kohëzgjatjen e masës alternative të shmangies;

ç) ecurinë e zbatimit të masës alternative të shmangies;

d) objektivat dhe/ose nevojat e planit të ndërhyrjes.

Neni 48

Mospërmbushja e masës së shmangies

Nëse i mituri, me qëllim, nuk e përmbush masën për shmangien nga ndjekja penale, Shërbimi i Provës informon me shkrim prokurorin, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar kohën, vendin, mënyrën dhe rrethanat e mospërmbushjes dhe situatën personale të të miturit, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Neni 49

Mbikëqyrja e dënimeve jo me burgim për të miturit

1. Shërbimi i Provës është përgjegjës për ekzekutimin e dënimeve jo me burgim për të miturin në konflikt me ligjin.

2. Prokurori i dërgon Shërbimit të Provës urdhrin e ekzekutimit të dënimit jo me burgim për të miturit, sipas përcaktimeve në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.



3. Specialisti i Shërbimit të Provës, përgjegjës për mbikëqyrjen, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e administrimit të urdhrit të ekzekutimit, verifikon përmbushjen vullnetare të detyrimit të personit nën mbikëqyrje për të vendosur kontakt me Shërbimin e Provës. Në rastin kur personi nën mbikëqyrje, në përfundim të afatit 7-ditor nuk ka përmbushur vullnetarisht detyrimin për të vendosur kontaktin me Shërbimin e Provës, specialisti përgjegjës për mbikëqyrjen i njofton atij detyrimin për të vendosur kontakt.

4. Specialisti i Shërbimit të Provës, përgjegjës për mbikëqyrjen, vendos kontakt me të miturin, prindin ose kujdestarin e tij ligjor dhe mbrojtësin brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

5. Për të realizuar përmbushjen e vendimit të dënimit jo me burgim, në varësi të dënimit të dhënë, specialisti i Shërbimit të Provës bashkëpunon me institucionet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore që ofrojnë shërbime për rehabilitimin dhe riintegrimin e personave nën mbikëqyrje. Shërbimi i Provës bashkëpunon gjithashtu me subjekte juridike private, organizata të shoqërisë civile dhe organizata ndërkombëtare, që punojnë në fushën e të drejtave të të dënuarve dhe shërbimeve në komunitet, me qëllim promovimin e riintegrimin në shoqëri të personave nën mbikëqyrje.

Neni 50

Mbikëqyrja e ekzekutimit të kufizimit të lirisë

1. Shërbimi i Provës ndjek ekzekutimin e vendimit për kufizimin e lirisë për të miturin në konflikt me ligjin.

2. Specialisti i Shërbimit të Provës cakton kohën dhe institucionin apo qendrën ku i mituri do të vendoset për t'u paraqitur vullnetarisht, me paralajmërimin se, në rast të mosparaqitjes vullnetare, vendimi do të ekzekutohet në mënyrë të detyruar.

3. Pas dërgimit të urdhrit të ekzekutimit nga prokurori, specialisti i Shërbimit të Provës kryen njoftimin në vendbanimin ose vendqëndrimin e të dënuarit të mitur, duke i bërë me dije kohën, institucionin ose qendrën, ku i mituri do të vendoset për t'u paraqitur vullnetarisht, me paralajmërimin se, në rast të mosparaqitjes

vullnetare, vendimi do të ekzekutohet në mënyrë të detyruar.

4. Njoftimi pasqyrohet në procesverbal dhe i dorëzohet të miturit, prindit ose kujdestarit të tij ligjor dhe mbrojtësit apo përfaqësuesit të tij ligjor.

5. Specialisti i Shërbimit të Provës informon institucionin ose qendrën, ku i mituri do të vendoset dhe datën e paraqitjes së tij.

6. Në rastet kur i mituri nuk paraqitet vullnetarisht, institucioni ose qendra njofton Shërbimin e Provës. Shërbimi i Provës njofton menjëherë prokurorin, i cili urdhëron ekzekutimin e detyrueshëm.

7. Pas sistemimit në institucion ose qendër, hartohet plani individual i trajtimit të të miturit dhe mbikëqyret ecuria e tij.

8. Shërbimi i Provës mbikëqyr zbatimin e programeve edukuese dhe rehabilituese nga i mituri dhe raporton periodikisht pranë prokurorit.

Neni 51

Mbikëqyrja e të miturve të dënuar, për të cilët gjykata ka vendosur qëndrimin në shtëpi

1. Në rastet kur gjykata cakton dënimin jo me burgim të qëndrimin në shtëpi për të miturin në konflikt me ligjin, Shërbimi i Provës vihet në kontakt me të miturin dhe harton planin individual të trajtimit, si dhe ndjek ecurinë e zbatimit të këtij plani.

2. Kur gjykata lejon të miturin të largohet nga banesa për të ndjekur procesin mësimor apo për të vazhduar punën, specialisti i Shërbimit të Provës, përgjegjës për mbikëqyrjen, harton planin individual të trajtimit në përputhje me masat e përcaktuara nga gjykata për kohën e kaluar jashtë shtëpisë dhe mbikëqyr mënyrën e respektimit të tyre nga i mituri.

3. Kur gjykata ka vendosur që qëndrimi në shtëpi të mbikëqyret në mënyrë elektronike, specialisti i Shërbimit të Provës bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen elektronike.



Neni 52

Mbikëqyrja e të miturve për të cilët gjykata ka vendosur kryerjen e një pune në interes publik

1. Në rastet kur gjykata vendos një dënim jo me burgim për kryerjen e një pune në interes publik nga i mituri, specialisti i Shërbimit të Provës përcakton institucionin apo shoqërinë, publike apo private, ku do të kryhet puna, në rastet kur nuk është përcaktuar nga gjykata, si dhe llojin e punës e ditët e javës.

2. Specialisti i Shërbimit të Provës, në përcaktimin e subjektit, ku do të kryhet puna, merr në konsideratë vendbanimin ose vendqëndrimin e të miturit, si dhe rrethana individuale të tilla, si: mosha, kushtet e jetesës, mënyra e rritjes dhe e zhvillimit fizik, edukimi dhe arsimimi, gjendja shëndetësore, gjendja familjare ose rrethana të tjera që ndikojë në ekzekutimin e vendimit.

3. Kur brenda juridiksionit të degës territoriale nuk ka një institucion të përshtatshëm, specialisti i Shërbimit të Provës cakton një institucion tjetër të së njëjtës natyrë, i cili ndodhet në njësinë administrative më të afërt me vendbanimin e të miturit.

4. Pas përcaktimit të subjektit, specialisti përgjegjës për mbikëqyrje harton planin individual të trajtimit për kryerjen e punës në interes publik, i cili përmban në shtojcë të tij:

- a) orët e punës në interes publik, datat e fillimit dhe mbarimit të punës në interes publik;
- b) institucionin apo personin juridik publik apo privat ku do të kryhet puna;
- c) përshkrimin e punës që do të kryhet;
- ç) periodicitetin e takimeve ndërmjet specialistit të Shërbimit të Provës dhe të miturit;
- d) detyrime të tjera të caktuara nga gjykata dhe mënyra e përmbushjes së tyre.

5. Specialisti i Shërbimit të Provës informon të miturin për detyrimin për të mbajtur kontakte të rregullta me Shërbimin e Provës, si dhe pasojat e moszbatimit.

6. Specialisti i Shërbimit të Provës e shoqëron të miturin në takimin e tij të parë në subjektin ku i mituri do të kryejë punën në interes publik, së bashku me prindin ose kujdestarin ligjor apo përfaqësuesin ligjor/procedural.

7. Para fillimit të kryerjes së punës në interes publik, Shërbimi i Provës, në bashkëpunim me subjektin pranë të cilit do të kryhet puna, i bëjnë të ditur të dënuarit rregullat e sigurimit teknik në punë.

8. Specialisti i Shërbimit të Provës, i mituri dhe subjekti, pranë të cilit do të kryhet puna, nënshkruajnë një marrëveshje. Në marrëveshje përcaktohen detyrimet e secilës palë, lloji i punës, oraret, periodiciteti dhe çështjet etike.

9. Gjatë mbikëqyrjes, specialisti i Shërbimit të Provës merr informacion periodik për progresin, ecurinë dhe probleme të mundshme në ekzekutimin e punës në interes publik.

10. Kur i dënuari paraqitet me vonesë, mungon pa arsye në punë ose nuk respekton rregullat për kryerjen, sjelljen dhe rendimentin në punë, subjekti, pranë të cilit kryhet puna me interes publik, njofton menjëherë Shërbimin e Provës.

Neni 53

Mospërmbushja e kushteve dhe detyrimeve

1. Kur specialisti i Shërbimit të Provës konstaton se i mituri nuk mban kontakte të rregullta me të, nuk kryen punën me interes publik apo shkel kushtet dhe detyrimet e tjera të caktuara nga gjykata, i raporton menjëherë prokurorit.

Neni 54

Përfundimi i punës me interes publik

1. Subjekti, pranë të cilit është kryer puna me interes publik, në përfundim të punës, pajis të miturin me vërtetimin përkatës dhe grafikun e shpërndarjes së orëve të punës.

2. Specialisti i Shërbimit të Provës harton raportin përfundimtar për kryerjen e orëve të punës bazuar në informacionin e marrë nga personi përgjegjës për frekuentimin, progresin dhe sjelljen e të miturit.

Neni 55

Përmbushja e detyrimeve të caktuara

1. Kur gjykata cakton ndaj të miturit në konflikt me ligjin dënimin jo me burgim, për përmbushjen e detyrimeve, për ndalimin e



frekuentimit të vendeve të caktuara apo shoqërimin me persona të caktuar, të cilët mund të ndikojnë negativisht në sjelljen dhe edukimin e tij, përcakton Shërbimin e Provës si organi kompetent që ndjek përmbushjen e këtyre detyrimeve.

2. Shërbimi i Provës është përgjegjës për miratimin e planit individual të trajtimit për të miturin në konflikt me ligjin.

3. Përmbushja e detyrimeve dhe procedura që ndjek Shërbimi i Provës bëhet sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe legjislacionin në fuqi që rregullon procedurën që do të ndiqet për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin.

Neni 56

Mbikëqyrja e ndalimit të kryerjes së një veprimtarie

1. Kur gjykata vendos se i mituri ndalohet të kryejë një veprimtari të caktuar për një periudhë kohore, prokurori i përcjell urdhrin e ekzekutimit Shërbimit të Provës, i cili mbikëqyr ekzekutimin e vendimit nga i mituri.

2. Specialisti i Shërbimit të Provës, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimit ndaj të miturit, vihet në kontakt me të miturin brenda 7 (shtatë) ditëve.

3. Specialisti i Shërbimit të Provës i bën me dije të miturit detyrimin për të mos kryer veprimtaritë e ndaluara të përcaktuara në vendimin e gjykatës. Specialisti mban kontakt të vazhdueshëm me të miturin për të verifikuar nëse janë respektuar urdhërimet e gjykatës.

4. Për ekzekutimin e dënimit, Shërbimi i Provës mund të bashkëpunojë me organe të tjera publike me qëllim mbikëqyrjen e veprimtarisë së të miturit.

5. Kur i mituri nuk paraqitet në takimet me specialistin e Shërbimit të Provës apo Shërbimi i Provës merr të dhëna se i mituri nuk zbaton urdhërimet e gjykatës, njofton menjëherë prokurorin.

KREU X

INSPEKTIMI NË SHËRBIMIN E PROVËS

Neni 57

Qëllimi dhe objektivat e inspektimit

1. Inspektimi ka si qëllim verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga specialistët e Shërbimit të Provës gjatë veprimtarisë së mbikëqyrjes së alternativave të dënimit me burgim, masave të shmangies dhe dënimeve jo me burgim për të miturit.

2. Qëllimi i inspektimit arrihet nëpërmjet:

a) vlerësimit të respektimit të kërkesave ligjore nga specialistët e Shërbimit të Provës, të cilët i nënshtrohen inspektimit;

b) rekomandimit për ministrin e Drejtësisë, drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit të Provës ose drejtorin e degëve territoriale për marrjen e masave të nevojshme për shkeljet e konstatuara;

c) marrjes së masave për përmirësimin e situatës dhe korrigjimin e shkeljeve të kërkesave ligjore brenda një afati të arsyeshëm.

Neni 58

Inspektimi

1. Inspektimi kryhet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës ose të ministrit të Drejtësisë, sipas programit, në bazë të kërkesës së degës territoriale, punonjësve të Shërbimit të Provës apo subjekteve të tjera të interesuara.

2. Llojet e inspektimit janë:

a) inspektimi tematik, i cili zhvillohet për një çështje të caktuar në bazë të informacioneve të përcjella në Shërbimin e Provës;

b) inspektimi i orientuar ose përgatitor, i cili synon mbledhjen e informacionit për fusha tërësisht ose pjesërisht të ndryshme nga inspektimet e mëparshme;

c) inspektimi në vazhdim, i cili shërben për të kontrolluar zbatimin e vendimit të mëparshëm;

ç) inspektimi rastësor, i cili zbatohet duke zgjedhur dosje të dënimeve alternative të rastësishme dhe të papërcaktuara më parë;

d) inspektimi i përgjithshëm, i cili ka si synim kontrollin e gjithë veprimtarisë së Shërbimit të



Provës, sipas periudhës së përcaktuar në urdhrin apo programin e inspektimit.

3. Kur drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës apo ministri i Drejtësisë, nëpërmjet denoncimeve të bëra publike në media, ankesave, njoftimeve apo në çdo formë tjetër, merr dijeni për mosrespektimin e legjislacionit në fuqi për Shërbimin e Provës, urdhëron kryerjen e inspektimit të paprogramuar. Subjekti iniciues, që ka bërë denoncimin, ankesën, njoftimin etj., nuk është palë në procedimin administrativ, në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative.

4. Në rastet e inspektimeve të paprogramuara inspektimi kryhet duke ndjekur të njëjtën procedurë, si në rastin e inspektimit të kryer mbi bazën e planit vjetor apo të planeve periodike.

Neni 59

Personat e autorizuar për të kryer veprime inspektimi

1. Inspektimi kryhet nga një grup prej jo më pak se 2 (dy) inspektorësh, ndërsa verifikimi i kërkesave, ankesave dhe informacioneve të tjera mund të kryhet dhe nga një inspektor. Në varësi të kompleksitetit të çështjes, drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për inspektimin, mund të vendosë që inspektimi të kryhet nga më shumë se 2 (dy) inspektorë. Të njëjtat rregulla zbatohen edhe kur inspektimi urdhërohet nga ministri i Drejtësisë.

2. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese, personat e ngarkuar për kryerjen e inspektimit identifikohen me një dokument identifikimi.

Neni 60

Përmbajtja e aktit të inspektimit

1. Në aktin për nisjen e inspektimit përcaktohen elementet e mëposhtme të planit të inspektimit:

- a) emri apo emërtimi i subjektit (degës territoriale) të inspektimit;
- b) objekti i inspektimit;
- c) baza ligjore;
- ç) periudha e inspektimit;
- d) afati i inspektimit;
- dh) procedura dhe metodat që do të ndiqen;

e) grupi i personave të autorizuar për kryerjen e inspektimit në rastin konkret;

ë) mënyra e dokumentimit të rezultateve të inspektimit;

f) informacione të tjera të nevojshme për kryerjen e inspektimit në rastin konkret;

g) data dhe vendi i lëshimit të aktit të nisjes së inspektimit.

2. Në rast se këto elemente nuk mund të përcaktohen plotësisht në momentin e nisjes së inspektimit, drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës apo ministri i Drejtësisë i përcakton ato në një akt të veçantë që pason aktin e nisjes së inspektimit.

Neni 61

Njoftimi për fillimin e inspektimit

1. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës apo ministri i Drejtësisë njofton paraprakisht me shkresë degën territoriale që do të inspektohet të paktën 2 (dy) ditë pune përpara nisjes së inspektimit, por, në raste të veçanta, inspektimi mund të jetë dhe i paparalajmëruar.

2. Njoftimi duhet të kryhet në formë të shkruar dhe bashkëlidhur tij duhet të jetë urdhri për nisjen e inspektimit.

3. Në njoftim e degës territoriale, e cila do t'i nënshtrohet inspektimit, mund të kërkohet përgatitja e akteve administrative të listuara në njoftim, si dhe materiale të tjera me rëndësi për inspektimin.

4. Drejtori i Përgjithshëm ose ministri i Drejtësisë kërkon në njoftim nga drejtori i degës territoriale që do të inspektohet, për të diskutuar paraprakisht për aspektet e realizimit të inspektimit, ndër të cilat:

- a) objektivat e inspektimit;
- b) vënien në dispozicion të dokumentacionit të nevojshëm, sipas urdhrin apo të programit inspektimit;
- c) sigurimin e kushteve të punës për grupin e inspektimit.

5. Subjekti i inspektimit nuk njoftohet paraprakisht në këto raste:

- a) kur ekziston rreziku se njoftimi mund të pengojë kryerjen me efektivitet të inspektimit;
- b) kur inspektimi ka për qëllim verifikimin e korrigjimit të shkeljeve, në përfundim të afatit të përcaktuar, në zbatim të detyrimeve të



parashikuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës.

6. Në rast të mosnjoftimit paraprak, inspektimi njoftohet njëkohësisht me fillimin e veprimeve të inspektimit nëpërmjet dorëzimit të aktit për nisjen e këtij procesi drejtorit të degës territoriale që do të inspektohet.

7. Në rast të refuzimit të marrjes së aktit të inspektimit apo mosgjatjes së drejtorit të degës territoriale, personi i ngarkuar për kryerjen e inspektimit e afishon ose e protokollon aktin në vendin ku kryhet inspektimi, duke pasqyruar në procesverbal këtë fakt.

Neni 62

Detyrimi për bashkëpunim i degës territoriale të Shërbimit të Provës

1. Dega territoriale, që i nënshtrohet inspektimit, është e detyruar të sigurojë informacionin e kërkuar dhe të bashkëpunojë me personat e ngarkuar për kryerjen e inspektimit. Nëse është e nevojshme, dega territoriale është e detyruar të përgatisë çdo material që kërkohet në funksion të inspektimit.

2. Nëse specialisti i Shërbimit të Provës ose drejtori i degës territoriale refuzon të sigurojë informacionin e kërkuar apo të bashkëpunojë me personat e ngarkuar për kryerjen e inspektimit, këta të fundit, duke respektuar parimin e hierarkisë, në varësi të subjektit, njoftojnë menjëherë drejtorin e degës territoriale apo drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

Neni 63

Inspektimi dhe vlerësimi i provave

1. Gjatë përmbushjes së detyrës, personat e ngarkuar për kryerjen e inspektimit shqyrtojnë të gjitha faktet e rrethanat e çështjes, inspektojnë dosjet dhe çdo dokument, përfshirë dokumentet elektronike, lidhur me administrimin e dosjeve të personave nën mbikëqyrje nga Shërbimi i Provës, marrin deklarime të çdo nëpunësi, duke respektuar parimin e hierarkisë, dhe vlerësojnë se cilat fakte do të merren si të provuara.

2. Në rast se në përfundim të procesit të inspektimit rezulton se ka mungesë faktesh, se faktet janë të paplota apo nuk janë bindëse dhe

nuk arrihet të formohet një bindje e brendshme, ky konkluzion pasqyrohet në raportin e inspektimit.

3. Nëse gjatë procesit të inspektimit nuk arrihet të respektohen afatet e vendosura, personat e ngarkuar për kryerjen e inspektimit kërkojnë zgjatjen e afatit të inspektimit, duke argumentuar edhe arsyet për mospërfundimin e procesit në afat.

4. Në rast vështirësish ose ndryshimesh të nevojshme të aktit të nisjes së inspektimit, personat e ngarkuar për kryerjen e inspektimit duhet të informojnë organin që ka urdhëruar inspektimin.

Neni 64

Dokumentimi i procesit të inspektimit

1. Gjatë procesit të këqyrjes së akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të të dhënave në degën territoriale, marrjes së deklarimeve nga specialisti i Shërbimit të Provës apo drejtori i degës territoriale, personat e ngarkuar për kryerjen e inspektimit dokumentojnë të gjitha veprimet e kryera në përmbushje të detyrës në një procesverbal që, sipas rastit, mund të jetë:

- a) procesverbal për marrjen e deklarimeve;
- b) procesverbal konstatimi;
- c) procesverbal këqyrjeje.

2. Nëse veprimet e inspektimit i kanë kryer 3 (tre) ose më shumë persona, në bazë të një akti të vetëm, ata e mbajnë procesverbalin së bashku ose veç e veç. Procesverbali hartohet në 3 (tri) kopje, të cilat nënshkruhen nga personat e ngarkuar për kryerjen e inspektimit dhe personat e marrë në pyetje apo të pranishëm gjatë hartimit të tij.

3. Procesverbali mbahet në vendin e kryerjes së inspektimit dhe i njoftohet menjëherë degës territoriale. Dega territoriale e inspektuar mund të paraqesë këndvështrime ndaj fakteve apo rrethanave të konstatuara nga personat e ngarkuar për kryerjen e inspektimit në procesverbal.

4. Procesverbali i inspektimit duhet të përmbajë:

- a) grupin e personave të ngarkuar për kryerjen e inspektimit;
- b) datën e kryerjes së inspektimit;
- c) objektin e inspektimit;



ç) përshkrim të hollësishëm për veprimet e kryera gjatë inspektimit, gjetjet dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit;

d) të drejtën e degës territoriale të inspektuar që të paraqesë me shkrim apo me gojë shpjegimet apo këndvështrimet e tij, për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal, brenda një afati të përcaktuar nga personat e ngarkuar për kryerjen e inspektimit;

dh) nënshkrimin në fund të çdo faqeje të personave të ngarkuar për kryerjen e inspektimit, të specialistit të Shërbimit të Provës apo personave të tjerë që kanë marrë pjesë në veprimet e inspektimit.

5. Në rastet kur specialisti i Shërbimit të Provës, subjekt inspektimi, kundërshton nënshkrimin e procesverbalit, ky fakt evidentohet në procesverbal, duke përmendur edhe arsyen nëse ka.

Neni 65

Trajtimi i rasteve që përmbajnë elemente të veprës penale

1. Nëse personat e ngarkuar për kryerjen e inspektimit, gjatë procesit të inspektimit, konstatojnë apo dyshojnë se janë kryer veprime, të cilat përbëjnë veprë penale sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, hartojnë një raport të shkurtër, të cilin e shoqërojnë edhe me dokumente provuese dhe e përcjellin menjëherë në strukturat përkatëse të institucionit, duke zbatuar parimin e hierarkisë.

2. Organi që ka urdhëruar inspektimin, pas shqyrtimit të këtij raporti, vendos për vazhdimin ose jo të inspektimit, si dhe përcakton planin e veprimit dhe modalitete të tjera për ndjekjen e rastit.

3. Në rast se gjatë inspektimit konstatohen veprime që përbëjnë veprë penale në kushtet e flagrancës, ndërpritet menjëherë shqyrtimi i mëtejshëm i çështjes dhe paraqitet kallëzim penal në prokurori.

4. Në rast se, në momentin e fillimit të inspektimit, personat e ngarkuar për kryerjen e inspektimit vijnë në dijeni se për të njëjtin objekt është duke u zhvilluar një procedim penal, pezullojnë inspektimin dhe vënë menjëherë në dijeni drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit të Provës ose ministrin e Drejtësisë.

Neni 66

Projektraporti i inspektimit

1. Me përfundimin e këqyrjes së akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të të dhënave në degën territoriale, ku po ushtrohet inspektim, personat e ngarkuar për kryerjen e inspektimit kryejnë përpunimin e të dhënave dhe përgatisin projektraportin e inspektimit.

2. Projektraporti i inspektimit përmban, në rend kronologjik, procedurat e kryera, një përshkrim të gjetjeve faktike, analizën ligjore të rastit, pavarësisht nëse janë konstatuar ose jo shkelje të ligjit dhe rekomandimet përkatëse.

3. Projektraporti i inspektimit, brenda 7 (shtatë) ditëve, nga dita e përfundimit të inspektimit, i paraqitet për miratim drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës ose ministrit të Drejtësisë, nëse inspektimi është urdhëruar nga ministri i Drejtësisë.

4. Pas miratimit, projektraporti i inspektimit i dërgohet degës territoriale të inspektuar për t'u njohur me gjetjet, për të komentuar dhe për të informuar në lidhje rekomandimet përkatëse. Komentet e degës territoriale i përcillen Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës ose ministrit të Drejtësisë, brenda 7 (shtatë) ditëve.

Neni 67

Raporti përfundimtar i inspektimit

1. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës ose ministri i Drejtësisë, pasi njihet me komentet e degës territoriale, shqyrton e vlerëson këto komente dhe urdhëron përgatitjen e raportit përfundimtar të inspektimit.

2. Personat e ngarkuar për kryerjen e inspektimit hartojnë raportin përfundimtar të inspektimit dhe, brenda 5 (pesë) ditëve, ia paraqesin drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës ose ministrit të Drejtësisë për miratim.

3. Raporti përfundimtar i inspektimit duhet të përmbajë në mënyrë të përmbledhur:

a) përbërjen dhe të dhënat e personave që kanë kryer inspektimin;

b) objektin e inspektimit;

c) pretendimet e kërkuesit nëse inspektimi është iniciuar në bazë të kërkesës së tij;

ç) problemet që janë konstatuar gjatë procesit të inspektimit;

d) komentet e degës territoriale;



e) vlerësimin dhe argumentet ligjore të personave të ngarkuar për kryerjen e inspektimit;

ë) rekomandimet për përmirësimin e situatës ose për marrjen e masave të nevojshme për shkeljet e konstatuara.

Neni 68

Dorëzimi i raportit përfundimtar degës territoriale të inspektuar

Raporti përfundimtar i inspektimit i dërgohet degës territoriale të inspektuar brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Neni 69

Përfundimi i procedimit kur nuk konstatohen shkelje

1. Kur konstatohet se nuk ka shkelje të kërkesave ligjore, procedimi administrativ i inspektimit përfundon me vendim përfundimtar, ku përcaktohen edhe arsyet për përfundimin e procedimit.

2. Dega territoriale, që është inspektuar dhe që ka paraqitur informacionin ose kërkesën për inspektim, njoftohet lidhur me vendimin përfundimtar.

Neni 70

Moszbatimi i raportit përfundimtar të inspektimit

Kur nuk janë zbatuar masat e lëna në raportin përfundimtar të inspektimit, drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës ose ministri i Drejtësisë mund të kërkojë marrjen e masave shtesë ose procedimin disiplinor, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil.

KREU IX DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 71

Akte nënligjore

Ngarkohet ministri i Drejtësisë që, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, të miratojë aktin nënligjor, në zbatim të pikës 2, të nenit 19, të kësaj rregulloreje.

UDHËZIM

Nr. 5, datë 25.6.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE MBI SHËRBIMET E DËRGESAVE TË PAKOVE POSTARE NDËRKUFITARE¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, pika 3 të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

1. Ky udhëzim ka për qëllim të rregullojë përcaktimin e kërkesave specifike për nxitjen e ofrimit më të mirë të shërbimeve postare ndërkufitare të pakove postare, në plotësim të përcaktimeve të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

2. Objekti i këtij udhëzimi lidhet me:

a) mbikëqyrjen rregullatore, në lidhje me shërbimet e dërgesave të pakove postare;

b) transparencën e tarifave dhe vlerësimin e tarifave për disa shërbime të dërgesave të pakove ndërkufitare, me qëllim identifikimin e atyre të cilat janë të larta pa asnjë arsye;

c) informacionin për konsumatorët të vëne në dispozicion nga tregtuesit, në lidhje me shërbimet e dërgesave të pakove ndërkufitare.

Neni 2

Përkufizime

Termet e përdorur në këtë udhëzim, kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e dhëna në nenin 3 të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenit 3, të ligjit 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar. Për qëllim të këtij

¹ Ky udhëzim bën përafrim të pjesshëm të rregullores (BE) 2018/644/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 18 prill 2018, “Mbi shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare” (CELEX 32018R0644).



udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Pako” objekt postar, i cili përmban mallra me apo pa vlerë tregtare, përveç objekteve të korrespondencës, me një peshë që nuk i kalon 31,5 kg;

b) “Shërbime të dërgesave të pakove”, shërbime që përfshijnë pranimin, përpunimin, transportin dhe shpërndarjen e pakove;

c) “Ofrues i shërbimit të dërgesave të pakove”, sipërmarrës që ofron një ose më shumë shërbime të dërgesave të pakove, përjashtuar sipërmarrësit që ushtrojnë aktivitetin vetëm brenda vendit, i cili ofron vetëm shërbime të dërgesave të brendshme të pakove, si pjesë e një kontrate shitjeje dhe si pjesë të kontratës e dorëzon personalisht mallin subjekt të kontratës të përdoruesi;

d) “Nënkontraktor”, sipërmarrës që ofron pranimin, përpunimin, transportin dhe shpërndarjen e pakove për llogari të ofruesit të shërbimit të dërgesave të pakove.

Neni 3

Dhënia e informacionit

1. Të gjithë ofruesit e shërbimeve postare që ofrojnë shërbimin e dërgesave të pakove, të paraqesin në AKEP, informacionin si më poshtë:

a) emrin, statusin dhe formën ligjore, numrin e identifikimit të subjektit në regjistrin tregtar, adresën dhe detajet e kontaktit të personit të kontaktit;

b) karakteristikat dhe, kur është e mundur, një përshkrim të detajuar, të shërbimeve të ofruara për dërgesat e pakove;

c) termat dhe kushtet e përgjithshme për shërbimet e dërgesave të pakove, përfshirë detajet për procedurat e ankimimit nga ana e përdoruesve dhe çdo kufizim të mundshëm të përgjegjësisë.

2. Nëse informacioni i kërkuar më sipër është depozituar më parë në AKEP, atëherë ofruesit e shërbimeve të dërgesave të pakove duhet të njoftojnë AKEP-in për çdo ndryshim të informacionit të cituar më sipër, brenda 30 ditëve nga momenti i ndryshimit.

3. Të gjithë ofruesit e shërbimeve të dërgesave të pakove, brenda datës 30 qershor të çdo viti

kalendrik, duhet të dërgojnë në AKEP informacionin si më poshtë:

a) të ardhurat vjetore nga shërbimet e dërgesave të pakove për vitin kalendrik paraardhës, të ndarë në shërbime të dërgesave të pakove të brendshme dhe të pakove ndërkufitare në dalje dhe në hyrje;

b) numrin e personave të cilët kanë punuar për ta gjatë vitit kalendrik paraardhës, të përfshirë në shërbimet e dërgesave të pakove, duke përfshirë ndarjen që tregon numrin e personave sipas statusit të punësimit dhe, në veçanti, ata të cilët punojnë me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, ata të cilët janë të punësuar përkohësisht dhe ata të cilët janë të vetëpunësuar;

c) numrin e pakove të përpunuara gjatë vitit kalendrik paraardhës, të ndarë në pako të brendshme dhe pako ndërkufitare në dalje dhe në hyrje;

d) emrat e nënkontraktorëve, së bashku me informacionin që disponojnë në lidhje me karakteristikat e shërbimeve të dërgesave të pakove ndërkufitare të kryera nga këta nënkontraktorë;

e) kur është e disponueshme, listën e çmimeve të aksesueshme publikisht, për shërbimet e dërgesave të pakove, të aplikueshme nga data 1 janar e çdo viti.

4. Format e raportimit për informacionin e kërkuar në pikat 1 dhe 3, miratohet nga AKEP-i tre muaj nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi. AKEP-i mund të vendosë kërkesa shtesë, përveç atyre të përcaktuara në pikat 1 dhe 3, nëse këto janë të nevojshme dhe proporcionale.

5. Pikat 1 deri në 4 nuk zbatohen për ofruesin/t e shërbimeve të dërgesave të pakove, që gjatë vitit kalendrik paraardhës kanë pasur të punësuar për të dhe të përfshirë në ofrimin e shërbimeve të dërgesave të pakove mesatarisht më pak se 50 persona, përjashtuar këtu ofruesit e shërbimit që operojnë si degë apo filiale të kompanive që operojnë dhe në vende të tjera. AKEP-i mund të përshijë në pragun e 50 personave dhe personat që punojnë për nënkontraktorin e ofruesit të shërbimeve të dërgesave të pakove. Pavarësisht kësaj, bazuar në specifikat e tregut postar dhe me qëllim proporcionaliteti të zbatimit të këtij udhëzimi, AKEP-i mund të kërkojë informacionin e paraqitur, sipas pikave 1 deri 4, edhe nga ofrues



të shërbimit të dërgesave të pakove, që gjatë vitit kalendarik paraardhës kanë punësuar mesatarisht nga 25 deri më 49 persona.

Neni 4

Transparenca e tarifave ndërkufitare

1. Të gjithë ofruesit e shërbimeve të dërgesave të pakove ndërkufitare, përjashtuar ofruesit e parashikuar në pikën 5, të nenit 3, brenda datës 31 janar të çdo viti kalendarik, i vënë në dispozicion AKEP-it listën publike të tarifave të zbatueshme nga data 1 janar e çdo vitit kalendarik, për dërgesat e çdo objekti të vetëm postar, përveç objekteve të korrespondencës, që bëjnë pjesë në kategoritë e listuara në aneksin 1.

2. AKEP-i, brenda datës 28 shkurt të çdo viti kalendarik, publikon të dhënat për tarifën e shërbimeve të dërgesave ndërkufitare për pakot e ofruara nga ofruesit e shërbimeve, duke siguruar që publikimi bëhet në një link të dedikuar të faqes së AKEP-it, e cila do jetë neutrale dhe jo me karakter tregtar.

Neni 5

Vlerësimi i tarifave të pakove të vetme ndërkufitare

1. Bazuar në listën e publikuar të tarifave, për çdo objekt të vetëm postar të listuar në aneksin 1 bashkëlidhur, AKEP-i identifikon tarifën ndërkufitare të ofruesit të shërbimeve të dërgesave të pakove që dërgohen nga Shqipëria dhe që janë subjekt i një detyrimi të shërbimit universal, për të cilat AKEP-i e konsideron objektivisht të nevojshëm vlerësimin.

2. AKEP, në përputhje me parimet e neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, vlerëson objektivisht tarifën ndërkufitare të identifikuar sipas pikës 1, me qëllim identifikimin e atyre tarifave ndërkufitare të konsideruara të larta pa asnjë arsye. Në këtë vlerësim, AKEP-i merr parasysh elementet në vijim:

a) tarifën e brendshme dhe çfarëdo tarife tjetër të shërbimeve të dërgesave të pakove të krahasueshme në vendin e destinacionit;

b) vëllimet reciproke, kostot specifike të transportit ose të përpunimit, kosto të tjera përkatëse dhe standardet e cilësisë së shërbimit;

c) impaktin e mundshëm të tarifave ndërkufitare të aplikuara mbi përdoruesit individual dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, përfshirë ato që ndodhen në zona të largëta ose më pak të populluara, dhe mbi përdoruesit individualë me aftësi të kufizuara, kur është e mundur duke mos vendosur një pengesë joproporcionale.

3. Përveç elementeve të mësipërme, AKEP-i, kur e konsideron të domosdoshme, mund të marrë parasysh veçanërisht elementet e mëposhtme:

i. nëse tarifën janë subjekt i një rregullimi të veçantë të çmimeve në bazë të legjislacionit kombëtar;

ii. abuzim i pozicionit mbizotërues në treg, i vendosur në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

Metodologjia që do të përdoret në lidhje me elementet e listuara më sipër miratohet nga ministri, brenda tre muajsh nga miratimi i këtyre rregullave.

4. Për qëllime të vlerësimit të cituar në pikën 2 të këtij neni, AKEP-i, kur e konsideron të nevojshme, mund të kërkojë informacione ose prova të tjera të nevojshme në lidhje me tarifën, për kryerjen e vlerësimit. Këto informacione ose prova do t'i vihen në dispozicion AKEP-it brenda një muaji nga marrja e kërkesës, së bashku me çfarëdo justifikimi për tarifën që po i nënshtrohen vlerësimit.

5. Në përfundim të vlerësimit, AKEP-i i dërgon ministrit vlerësimin e kryer deri më 30 qershor të vitit kalendarik përkatës, duke respektuar kërkesat ligjore për konfidencialitetin tregtar në informacionin e vënë në dispozicion. Ky vlerësim vihet në dispozicion të publikut.

Neni 6

Informacioni për konsumatorët

Për kontratat që përfshihen në fushën e veprimtarisë së ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorit”, të ndryshuar, të gjithë tregtarët që lidhin kontrata shitjeje me konsumatorët, të cilat përfshijnë dërgimin e pakove ndërkufitare, kur është e mundur dhe e zbatueshme, vënë në dispozicion, në fazën parakontraktuese, informacionin rreth opsioneve të ofrimit të dërgesave ndërkufitare, në lidhje me



kontratën specifike të shitjes, tarifat që paguhen nga konsumatorët për dërgesën e pakove ndërkufitare, si dhe politikat e tyre të trajtimit të ankesave.

Neni 7

Konfidencialiteti

Çdo informacion tregtar konfidencial i dërguar në përputhje me këtë udhëzim tek AKEP-i ose te ministria përgjegjëse do t'u nënshtrohet kërkesave të konfidencialitetit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Zbatimi

Zbatimi i këtij udhëzimi, lidhur me informacionin e kërkuar sipas nenit 3 të këtij udhëzimi, nuk anashkalon detyrimet e ofruesve të shërbimit të dërgesave të pakove postare, sipas legjislacionit kombëtar përfshirë ato për procedurat e nevojshme lidhur me autorizimin e tyre sipas ligjit për shërbimin postar, si dhe rregullat e zbatueshme për çështjet sociale dhe të punësimit.

Neni 9

Gjobat

Për mosrespektimin e kërkesave të parashikuara në këtë udhëzim nga ofruesit e shërbimit të dërgesave të pakove, merren masa administrative, sipas parashikimeve në ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda BALLUKU

ANEKSI 1

Objektet postare të vetme, për të cilat tarifat e ofruesit të shërbimeve të dërgesave të pakove u nënshtrohen masave të transparencës së çmimeve dhe vlerësimit të parashikuar në nenet 4 dhe 5:

- a) letër standarde 500 g (brenda dhe jashtë vendit);
- b) letër standarde 1 kg (brenda dhe jashtë vendit);
- c) letër standarde 2 kg (brenda dhe jashtë vendit);
- d) letër e regjistruar 500 g (brenda dhe jashtë vendit);
- e) letër e regjistruar 1 kg (brenda dhe jashtë vendit);
- f) letër e regjistruar 2 kg (brenda dhe jashtë vendit);
- g) letër e gjurmueshme 500 g (brenda dhe jashtë vendit);
- h) letër e gjurmueshme 1 kg (brenda dhe jashtë vendit);
- i) letër e gjurmueshme 2 kg (brenda dhe jashtë vendit);
- j) pako standarde 1 kg (brenda dhe jashtë vendit);
- k) pako standarde 2 kg (brenda dhe jashtë vendit);
- l) pako standarde 5 kg (brenda dhe jashtë vendit);
- m) pako e gjurmueshme 1 kg (brenda dhe jashtë vendit);
- n) pako e gjurmueshme 2 kg (brenda dhe jashtë vendit);
- o) pako e gjurmueshme 5 kg (brenda dhe jashtë vendit);

Objektet postare të listuara në pikat “a” deri “o”, duhet të përmbushin kriteret në vijim:

- a) përmasat limit të objekteve postare të listuara në pikën “a” deri “i”, si më poshtë:
 - gjatësia, gjerësia dhe trashësia e kombinuar: 900 mm;
 - përmasa më e madhe nuk duhet t'i kalojë 600 mm;
 - përmasa më e vogël nuk duhet t'i kalojë 20 mm;
- b) pakot e listuara në pikat “j” deri “o” nuk duhet të jetë më të vogla se përmasa e përshkruar për ato të listuara në pikat “a” deri “i”.



Elemente që duhen marrë parasysh kur dërgohet informacioni mbi tarifatat për pikat nga “a” në “o”:

1. Tarifatat korresponduese të objekteve postare duhet të jenë për një objekt të vetëm dhe të mos përmbajnë zbritje të veçanta, në bazë të vëllimit ose të ndonjë trajtimi tjetër të veçantë;

2. Vlera e tarifës do t’i raportohet në AKEP pa TVSH;

3. Ofruesit që ofrojnë më shumë se një objekt postar që përmbush kriteret e mësipërme duhet të raportojnë tarifën më të ulët;

4. Tarifatat e mësipërme do të jenë për objektet postare të dorëzuara në shtëpi ose në ambientet e tjera të destinacionit, ose në ambientet e tjera të kërkuara nga adresuesi, nëse një tarifë e tillë e përfshin këtë mundësi, pa pagesë shtesë.

KËRKESË

Nr. 4840/4, datë 8.7.2021

PËR SHPRONËSIM DHE/OSE PËR SHKËMBIMIN E PRONËS, PËR INTERES PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim dhe/ose për shkëmbimin e pronës, për interes publik, në zonën e re për zhvillim në Njësinë Administrative Marikaj, Bashkia Vorë.

Njësia zbatuese për këtë projekt është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim dhe/ose për shkëmbim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, si:

1. Për pasurinë e llojit është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”;

2. Për pasuritë e llojit “ndërtesë”, me funksion banimi dhe “ndërtesë”, me funksion jobanimi, është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, bazuar në çmimet mesatare të Entit Kombëtar të Banesave, për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit, për vitin 2016;

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare dhe në portalin unik qeveritar për rindërtimin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Bashkisë Vorë, si dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke u shprehur nëse pranojnë kalimin vullnetar të pronësisë me kushtet e ofruara.

Kërkesa për shpronësim dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit, është me vlerë totale paraprake të kompensimit nga shpronësimi në shumën 9 517 469 (nëntë milionë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR
I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMIT DHE/ OSE
SHKËMBIMIT
Erlis Hereni**

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë